



QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

FJALA FJALËI

100
DITË

QEVERI PËR QYTETARËT ●





PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Mirënjohje	8
Ministria e Mbrojtjes	9
Ministria e Punëve të Brendshëm	11
Zëvendëskryetari i Qeverisë për çështje evropiane	13
Zëvendëskryetari i Qeverisë për çështje ekonomike	16
Zëvendëskryetari i Qeverisë për implementimin e Marrëveshjes Kornizë dhe sistemit politik	17
Ministria e Punëve të Jashtme	18
Ministria e Financave	22
Ministria e Shëndetësisë	25
Ministria e Drejtësisë	27
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	29
Ministria e Ekonomisë	30
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të ujrave	32
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	35
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	37
Ministria e Arsimit dhe Shkencës.....	41
Ministria e Vetqeverisjes Lokale.....	44
Ministeria e Kulturës	46
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	49
Ministri pa resor i angazhuar për komunikim, llogaridhënie dhe transparencë	51
Ministri pa resor i angazhuar për marrëdhënie me Diasporën	53
Ministri pa resor i angazhuar për investimet e huaja	54
Ministri pa resor i angazhuar për avancimin e klimës investuese për ndërmarrjet e vendit ..	55
Ministri pa resor i angazhuar për implementimin e Strategjisë për avancimin e gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë	57
Ministrja pa resor e angazhuar për investime të huaja	58
Ministrja pa resor e angazhuar për investime të huaja	59

PARATHËNIE

Të nderuar përfaqësues të mediave, të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë!

Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e cila filloi me punë më 1 qershor të këtij viti, para jush - qytetarë të Republikës së Maqedonisë sot përmbledh rezultatet e punës së saj. Këto janë rezultatet të arritura pas një krize jashtëzakonisht të vështirë për vendin tonë. Nga kjo situatë fitues dolën qytetarët. Hymë në fazë të re, në të cilën krijuam një ambient politik krejtësisht të ri, ku dominon transparenca, përgjegjësia, llogaridhënia dhe politikat e arsyeshme në interes të të gjithë qytetarëve.

Bashkërisht definoam se luftojmë për jetë në liri dhe jetë më të mirë për të gjithë ne, në një shoqëri për të gjithë.

Hapëm shumë procese të reja. Shumë prej tyre as që mund të paramendoheshin në praktikën tonë politike. Për shembull: Zbardhëm marrëveshjet sekretet që kanë bërë Qeveria, ministritë, agjencitë, drejtoritë.

Tashmë sekretja është publike!

Hapëm shumë procese të reja. Shumë prej tyre as që mund të paramendoheshin në praktikën tonë politike. Për shembull: Zbardhëm marrëveshjet sekretet që kanë bërë Qeveria, ministritë, agjencitë, drejtoritë. Tashmë sekretja është publike!

Vumë sërish në funksion shumë organe të rëndësishme punuese të bllokuara, të harruara. Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë siguroam pjesëmarrje personale të vetë drejtorëve të shërbimeve të sigurisë.

Në këto 100 ditë udhëhiqeshim nga PEsË parime, PEsË obligime dhe përcaktime të ndërmarra. PARATË TË KTËHENEN TE QYTETARËT, të sigurojmë **ZHVILLIM EKONOMIK PËR JETË MË TË MIRË**, t'iu japim një pasqyrë miqësie, **INSTITUCIONET T'I BËJMË TË JENË NË SHËRBIM TË QYTETARËVE**, në të gjitha vendimet tona qytetarët të shohin QEVERI TË HAPUR REFORMUESE, dhe vendin tonë ta promovojmë, **MAQEDONIA MIKE E FQINJËVE**, e cila fuqishëm hapëron drejt RRUGËS NË NATO DHE BASHKIMIN EVROPIAN.

Fjala tani është realitet. Fjala e dhënë u shndërrua në përfitim konkret për qytetarët. Kjo Qeveri është Qeveri e qytetarëve dhe interesave të tyre. Detektuam këto interesa dhe bëmë zgjidhjen më të mirë të mundshme. Madje akoma më shumë: **ZGJIDHJET BËHEN REALITET, TË SHNDËRRUARA NË MASA NË DOBITË QYTATRËVE , TË CILAT NJËJKOHËSISHT JANË INSPIRIM PËR HAPA TË REJA!**

Të nderuar përfaqësues të medimeve, të nderuar qytetarë, para 100 ditëve filloi aksion për **KTHIMIN E PARAVE TE QYTARËT!**

Kjo Qeveri që në fillimin e punës së saj u ballafaqua me sfidën e madhe, të bëjë rebalancim të buxhetit, në krijimin e të cilit ajo nuk mori pjesë.

Detyra jonë ishte të lokalizojmë harxhimet e parapara joproduktive, joracionale, harxhimet e pa nevojshme dhe të gjejmë bazë që paratë e parapara për harxhime jo esenciale, t'i ridestinojmë për nevojat e qytetarëve dhe kompanive.

Nuk kemi ndërmend të financojmë luksin e aparatit shtetëror. Kjo Qeveri nuk ka ndërmend të mbyll paratë në harxhime joproduktive, siç ishin reklamimet e propagandës dhe luksit të funksionarëve të lartë shtetëror, me para të pakontrolluara për reprezentacione dhe udhëtime zyrtare boshe. **Mjaft ishte!**



Kjo Qeveri ka qëllim dhe përcaktim të fuqishëm të sillet si nikoqire e denjë, të ekonomizojë paratë e qytetarëve.

Vetëm me shkurtimin e buxhetit të kryeministrit siguroam 420 milion denarë. Bashkë me paratë e tjera të fituara nga qasja e këtillë, realizuam programe të cilët do të realizohen me kthimin e parave në shërbim të qytetarëve, privilegjeve dhe aksioneve konkrete.

- Siguroam edhe 1245 milionë denarë të tjera nga Fondi për Sigurim Pensional dhe Inavlidor, që të bëhet pagesa në kohë dhe e pandërprerë e pensioneve dhe harxhimeve të shtyllës së dytë pensionale, si dhe 200 milion denarë të tjera për të paguar TË GJITHA transferimet e garantuara sociale të qytetarëve.

Me ndryshimet dhe plotësimet e Buxhetit për vitin 2017 siguroam mjete për:

- Subvencionimin e pagës minimale, dhe ajo të jetë 12 mijë denarë. Me këtë masë janë përfshirë rreth 70 mijë bashkëqytetarë tanë të punësuar;
- Përgjithmonë zgjidhëm problemin e me punëtorët e falimentuar, të cilët deri më tani nuk ishin pjesë e zgjidhjeve ligjore aktuale, për rreth 3000 persona dhe familjet e tyre;
- Siguroam 60 milionë denarë për përkrahjen e kapaciteteve turistike në Republikën e Maqedonisë dhe për pushimeve vjetore për punëtorët që paguhen më pak;
- Me 9 milion euro, ose afërsisht 500 milion denarë përkrahim politikat aktive dhe masat për mbështetje të punësimeve të reja dhe realizimin e projektit "Garanci për të rinjtë", sepse duam që ata të mbeten në Maqedoni;
- Siguroam 135 milionë për përkrahje të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe për përkrahje të investimeve vendore "grinfeld".

Puna me ekonomizim na mundësoi që të mbajmë edhe një fjalë të dhënë - filluam procesin për heqjen e taksës së radiodifuzionit.

Të nderuar më lejoni të shpalos edhe disa nga vendimet e rëndësishme:

Kjo Qeveri drejtpërdrejtë iu doli krah bujqve, me një varg masash të reja nga Programi i Qeverisë. Edhe atë që në 100 ditët e para. Pako me 10 milion euro, arrin në duart e kopshtarëve, vreshtarëve, blegtoreve dhe agrarëve.

Kjo nënkupton edhe përkrahje të prodhimtarisë së vendit.

Masë jashtëzakonisht e rëndësishme për përkrahje financiare prej 10.000 euro, mjete të pakthyeshme për bujkun e ri.

Këto janë vendime që pa hamendje ilustrojnë se gjithmonë do të gjejmë programe dhe masa kreative, me të cilat paratë do t'ua kthejmë qytetarëve.

Një masë e këtillë është edhe rikthimi i tarifës së lirë për energjinë elektrike.

Ishim të bindur se një mundësi e tillë ekziston. Me një qasje të re dhe ekonomizim të punës së ELEM-it dhe MEPSO-s, kursimet e tyre do të transmetohen si përfitim i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, siç ishte tarifa e lirë e energjisë elektrike, për të gjithë.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë!

Të gjitha këto vendime të Qeverisë që përmenda deri më tani, janë bërë vetëm për 100 ditë, janë vendime që realisht janë të qëndrueshme dhe që zbatohen në bazë të parametrave dhe politikave reale për **ZHVILLIMIN EKONOMIK PËR JETË MË TË MIRË.**

Rebalancim i buxhetit është bërë në bazë të projeksioneve reale dhe parimeve zhvillimore.

Premtuam, se në 100 ditët e para të mandatit do të publikojmë shumën e përgjithshme të të gjitha obligimeve të akumuluar për biznesin. Borxhin e kthejmë.

Trashëguam borxh publik jashtëzakonisht të madh dhe të krijuar panevojë. Me qasje reale dhe me analiza thelbësore të zgjidhjes, arritëm të kthejmë borxhet dhe të ulim huamarrjet me normë shumë të ulët të interesit. Krijojmë politika fiskale dhe financiare të cilat do të sigurojnë që **zhvillimi të ul borxhin**.

Zhvillimi do të ul borxhin. Për këtë krijuam kushte! Kushtet që vlenin për kompanitë e huaja, tani do të vlejné edhe për kompanitë e vendit. Me kompanitë e vendit do të shkruajmë faqen e re të ekonomisë së Maqedonisë.

Të përmend vetëm edhe disa masa me të cilat siguroam kushte për nismat e biznesit:

- Përforduam kapacitetin financiar dhe kadrovik të Agjencisë për Përkrahje të Sipërmarrjes, për koordinim dhe zbatimin e politikave për zhvillim të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Banka e Maqedonisë për Zhvillim të kapitalizohet edhe më tej, që të rritet përkrahja kreditore dhe aftësimi për realizimin e saj në skemën e garantuar.
- Miratuam masa të parandalojmë konkurrencën jo lojale dhe të përforcojmë kontrollin e mirëfilltë të prodhimeve.

Fituam përkrahjen e plotë për ndryshime të politikës ndëshkuese. Insistojmë që në themelin e kësaj politike të jetë parandalimi, e jo represioni ndëshkues.

Krijuam kushte për siguri juridike me të cilat pronarët dhe punëdhënësit do të mbrohen nga presionet dhe frika.

Politikat e Qeverisë për energjetikën, transportin dhe infrastrukturën, morën përkrahjen e plotë në Samitin e Triestes. Një nga rezultatet në Trieste është Marrëveshja për themelimin e bashkësisë transparentuese të Ballkanit Perëndimor, projekt që hap mundësi jashtëzakonisht të favorshme për ZHVILLIMIN EKONOMIK DHE JETË MË TË MIRË.

Krijuam histori të suksesshme. Samiti në Trieste është histori e mësuar mirë: Politika rajonale dhe fqinjësisë së mirë gjithmonë jep rezultate. Për shembull: Memorandumi për bashkëpunim për lidhjen hekurudhore me Republikën e Bullgarisë, si rezultat konkret me Marrëveshjen me Bullgarinë për bashkëpunim, miqësi dhe fqinjësi të mirë, siguroi 70 milion euro për ndërtimin e hekurudhës drejt Republikës së Bullgarisë si pjesë e Korridorit 8.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë,

Politikat e suksesshme të deritanishme dhe të ardhshme, të kësaj Qeverie janë rezultat i përcaktimit që INSTITUCIONET T'I VEMË NË SHËRBIM TË QYTETARËVE. Të sigurojmë që institucionet të shndërrohen dhe të jenë në shërbim dhe jetë më të mirë të qytetarëve. Para se gjithash në interes të qytetarëve.

Fillimisht, më lejoni, të shpalos faktin se tani mediumet kanë mundësinë që shumë shpejt dhe me informacione drejtpërdrejtë, opinionit të gjerë t'i transmetojnë për aktivitetet dhe vendimet e punës sonë, edhe atë në sajë të informimit (brifingut) javor që kemi me gazetarët dhe redaktorët. Drejtpërdrejtë nga burimi i informacioneve, me mundësinë menjëherë të marrin përgjigje për të gjitha pyetjet e tyre. Në çdo pyetje përgjigjemi saktë, në afat sa më të shkurtër kohor. Jemi të hapur, llogaridhënës dhe në dispozicion në çdo kohë.

Në disa nga ministritë, si për shembull në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, praktikohet "Dita e hapur për qytetarët", çdo të premte nga ora 9:00 - 13:00.

Qeveria shkurtoi, thjeshtësoi dhe bëri me kosto më të ulët procedurat të shumë shërbimeve për qytetarët, sidomos nga shërbimet e çështjeve sociale, civile dhe ato administrative.

Dëgjuam porositë e qytetarëve dhe komunitetit të biznesit, dhe nga 1 shtatori filloi të zbatohet vendimi i orarit të ri të punës, me dy turne të punës në administratën publike dhe nëpër çerdhe.

Hoqëm testimin ekstern. Filluan ndryshimet rrënjësore të programeve arsimore.

Rritëm numrin minimal e ditëve për konsultim të Regjistrisë të vetëm nacional elektronik të rregulloreve, nga 10 në 20 ditë. Me këtë qytetarëve dhe të biznes komunitetit, më shumë kohë për debat publik për kontribut dhe avancim të propozim të rregullave ligjore që në fazën e parë të miratimit.



Vazhduam afatin e legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje.

Që krejtësisht të vij në shprehje parimi INSTITUCIONET NË SHËRBIM TË QYTATRËVE, dhe atë për të gjithë qytetarët, filluam hartimin e Strategjisë kombëtare për bashkëpunim me Diasporën, me qëllim të afrimit të Diasporës me Republikën e Maqedonisë, dhe zhvillimin e bashkëpunimit për më shumë fusha.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë,

Dhamë fjalën se kjo Qeveri do të jetë e **HAPUR DHE REFORMUESE**. Para të gjithë juve, më 5 qershor prezantuam Planin 3-6-9.

Sot, pas dy muajsh, më 5 shtator, informojmë:

- Qeveria dha të gjithë mbështetjen konkrete për proces korrekt dhe demokratik të zgjedhjeve, me udhëzime të sakta, që orientojnë çdo funksionar qeveritar dhe të punësuar në institucionet shtetërore që duhet të shmangen gjatë kohës parazgjedhore dhe cilat janë pasojat nga mosrespektimi i Kodit Zgjedhor.
- Qeveria mori obligim që me patjetër dhe hollësisht t'i shpjegojë të gjithë propozimet ligjore dhe do një herë në javë do të mund të parashtrihen pyetje për deputetët. Qeveria është në dispozicion të Kuvendit për vendosjen e mbikëqyrjes efikase, të rregullt dhe rutine mbi shërbimet e inteligjencës.
- Harmonizuam dhe miratuam tekstin për Ligjin e gjuhëve, i cili përmbyll edhe çështjen e fundit nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit.
- Avancuam konceptin për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe organizatave qytetare.
- Çdokush ka kontroll në punën e Qeverisë. Para çdo seance publikojmë agjendën ditore, dhe pas çdo seance publikojmë raportin/ procesverbalin nga vendimet qenësore të miratuara nga Qeveria.
- Në procedurë të përcaktimit të versionit përfundimtar të propozim -ligjit për shërbime mediateke audio dhe audiovizuale.
- Ndërpresim reklamat qeveritare që nga faktori ndërkombëtar dhe ai vendas u vlerësuan si presion dhe kontroll ndaj medimeve, dhe njëkohësisht do t'i publikojmë të gjitha harxhimet e deritanishme për këto reklama.
- Hartuam shqyrtim të të gjithë rasteve të frikësimit, presioneve dhe gjuhës së urrejtjes kundër gazetarëve, që të nxitet gazetaria e lirë dhe në të ardhmen mos përsëriten praktikat e këtilla. Qeveria falas në dispozicion të gjitha informacionet të Regjistrisë qendror dhe Kadastrës për gazetarët të cilët punojnë gazetari hulumtuese.
- Zbardhëm edhe informacionet që kanë të bëjnë me udhëtimet zyrtare, reprezentacionet dhe ndarja e ndihmës shtetërore për kompanitë e huaja. Nuk mund të ketë dëm nëse opinioni i gjerë ka pasqyrë më të qartë sesi Qeveria ka në dispozicion paratë dhe mbron interesat e qytetarëve.
- Janë formuar të gjitha grupet e nevojshme punuese, për hartimin e zgjidhjeve ligjore më të rëndësishme si dhe Këshillit për zbatimin e reformave në gjyqësi, kurse kësaj jave do të përfundojnë përgatitjet për Strategjinë reformuese të sektorit gjyqësor.
- Qeveria do të sigurojë përkrahje për përforcimin e stafit të Avokatit të Popullit.
- Përsoset sistemi i luftës kundër terrorizmit dhe aktiviteteve për reforma në strukturat e sigurisë dhe të inteligjencës, të harmonizuara me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare.

Plani 3-6-9 na rikthen në garën e shpejt të proceseve euro-integruese dhe Republikën e Maqedonisë ta promovojmë si MIKE E VENDEVE FQINJE, VEND I CILA FUQISHËM HAPËRON DREJT NATO-s DHE BASHKIMI EVROPIAN!

Në këto 100 ditët e kaluara, nuk kishte ditë pa takim me miqtë tanë nga bashkësia ndërkombëtare. Të gjithë partnerët dhe miqtë tanë na ofruan përkrahje pa rezervë. Të gjithë njohën përcaktimin dhe synimin tonë: Maqedonia të jetë e pranueshme, dhe ajo të shihet si **MIKE, në RRUGËN DREJT NATO-s DHE BASHKIMIT EVROPIAN!**

Republika e Maqedonisë u bë partnere e dëshiruar, me të cilën ia vlen dhe duhet të llogarisin sfidat politikat ndërkombëtare, rajonale dhe ato të fqinjësisë së mirë.

Nënshkrimi i Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim ndërmjet Maqedonisë dhe Bullgarisë dëshmoi se atje ku ka vullnet politik dhe ide për progres, problemet zgjidhen.

Kjo Marrëveshje është inspirim dhe model bashkëpunimi për rajonin dhe më gjerë. Kjo është kështu, sepse kjo Qeveri u përcaktua të udhëheq politikë të zgjidhjes, e jo të problemit.

Ky është qëndrimi ynë, është pjesë e re-afirmimit të marrëdhënieve me Republikën e Greqisë. Vetëm qasje pozitive në zgjidhjen e çështjeve të hapura mes shteteve, me respekt të ndërsjellët dhe mirëkuptim, kjo është e ardhmja e rajonit.

Në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Trieste, në kuadër të procesit të Berlinit, me përkrahje të Bashkimit Evropian, në mënyrë proaktive marrim pjesë në iniciativën që do të ndryshojë pasqyrën, historinë, por edhe ekonominë si dhe standardin e qytetarëve në vend dhe rajon. Nga një vend që prodhon kriza, në rajon të sigurt dhe të qëndrueshëm. Afirmimi që morëm nga Angela Merkel, nga Boris Xhonsos dhe Emanuel Makron është i padiskutueshëm.

Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me stërvitjet ushtarake në Krivollak, i vumë në rrafsh tjetër cilësor në planin global të sigurisë. Takimi me nënkryetarin Pens në Podgoricë, ishte afirmimi i ri aspiratës sonë për në NATO.

Përkrahja për përcaktim të fuqishëm të Qeverisë Reformuese të Republikës së Maqedonisë, për rikthimin e vendit drejt rrugës së eurointegritimeve, pa rezervë arriti edhe nga Mbretëria e Suedisë dhe Mbretëria e Norvegjisë. Republika e Finlandës pa kursim na ofroi asistim në reformat e arsimit, sërish për shkak të profilit reformues të Qeverisë.

Dje nga Izraeli u kthëm me frymë të re. Kursi reformues i Qeverisë sonë hap perspektiva serioze për bashkëpunim dhe me këtë vend.

Edhe kjo vizitë ishte kontribut i përcaktimit të Republikës së Maqedonisë të shihet si **MIKE dhe PARTNERE, në RRUGLËN DREJT NATO-s dhe BASHKIMIT EVROPIAN!**

Të nderuar qytetarë të Republikës së Maqedonisë,

Siç përmenda, Qeveria ka krijuar të gjitha kushtet e domosdoshme për zgjedhje lokale korrekte. Po hyjmë në përmbylljen edhe të një vullneti tjetër të shprehur lirshëm nga qytetarët- zgjedhjet lokale. Kjo është skena e re, ku kjo Qeveri dëshmon se do të rikthej besimin e institucioneve dhe rikthejmë jetën! Krijiam shoqëri të barabartë për të gjithë, për të gjithë qytetarët e këtij vendi. Krijiam kushte që të rinjtë të mbeten dhe të punojnë këtu, në Maqedoninë tonë të bukur.

Te qytetarët shohim shpresën e ringjallur. Jemi të vendosur të rikthejmë dinjitetin njerëzor. Kjo është Qeveri e qytetarëve dhe Qeveri për qytetarët. Kjo është Qeveri e fjalës. Kjo Qeveri është reformuese dhe e hapur të udhëheq politika jetësore.

FJALA FJALË!



MIRËNJOHJE

“Fjala fjalë - 100 ditë Qeveri për qytetarët” është raport i Qeverisë së Republikës, e cila filloi me punë më 1 qershor të këtij viti dhe përmbledh rezultatet e punës së saj para jush - qytetarë të Republikës së Maqedonisë. “Fjala fjalë- 100 ditë Qeveri për qytetarët” është raport i hartuar me përkushtim serioz të ministrive edhe do doja që t’i falënderohem për përkrahjen e tyre në zhvillimin e dokumentit.

MINISTRIA E MBROJTJES

(zëvendëskryetare e Qeverisë dhe ministre e mbrojtjes Radmilla Sheqerinska)

Ministria e Mbrojtjes vë fokusin në reformat kyçe të mbrojtjes dhe anëtarësimin në NATO. Rifillimin e procesit të bllokuar për përpunimin e Shqyrtimit strategjik të mbrojtjes, i cili është dokument i rëndësishëm për reformat në Armatë dhe anëtarësimin në NATO. Me rebalancin e buxhetit, janë siguruar mjete plotësuese për pagat që mungonin për të punësuarit në MB dhe ARM, solli vendim për dëmshpërblim të të punësuarve të MB-së dhe ARM-së pas përmbytjeve të rrethinës së Shkupit, për angazhimin e ARM-së në fikjen e zjarreve në Maqedoni, si dhe vendimin për hapjen e kampit ushtarak në Ohër për qytetarët. Ministria e mbrojtjes zbardhi të gjitha dokumentet për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë vendit, si dhe harxhimet për reprezentacionet. Është depërtuar për të prezantuar politikën e re për bashkëpunim dhe fqinjësisë së mirë, janë realizuar takime zyrtare me ministrat e mbrojtjes të Sllovenisë, Shqipërisë, Bullgarisë, Rumanisë si dhe me ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere, në takimin e Këshillit Euroatlantik të NATO-s në Bruksel. Janë organizuar mbi 10 evenimente dhe janë realizuar mbi 40 takime me familjet e ushtarëve të rënë (“бранители”), pjesëtarët e ARM-së, të cilët kanë marrë pjesë në misionet paqësore, përfaqësuesit të institucioneve shtetërore nga vendi dhe jashtë vendit, institucionet ndërshtetërore dhe ambasadave. Realizimi i stërvitjes Dragoon Gurdian në Krivollak, me të cilën u transmetua porosi për partneritet dhe bashkëpunim ndërmjet ushtrisë amerikane dhe maqedonase.

Reforma

- Vendim për rifillimin e procesit të bllokuar për përpunimin e Shqyrtimit strategjik të mbrojtjes dhe anëtarësimin në NATO;;
- **Zbardhjen e të gjitha dokumenteve për udhëtimet zyrtare në vend dhe jashtë shtetit dhe harxhimet për reprezentacionet (3-6-9);**
- Sigurimi i mjeteve për paga dhe rebalancë të buxhetit;
- Vendimi për hapjen e kampit ushtarak në Ohër për qytetarët, pas serisë së tërmeteve në këtë rajon;
- Vendim për dëmshpërblim të të punësuarve në MB dhe ARM pas përmbytjeve në rrethinën e Shkupit;
- Vendim për Grupin drejtues për angazhimin e ARM-së në shuarjen e zjarreve në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe
- Ndryshime të procedurës për pranim të studentëve/kadetëve të Akademisë Ushtarake me rritje të transparencës

Njëmbëdhjetë evenimente

- Pjesëmarrje e ministres Shekerinska në “Ditën për miq të nivelit të lartë” në stërvitjen “Saber Guardian 17” në Romani;
- U realizua stërvitja “Dragoon Guardian 17” në Krivollak;
- Pjesëmarrje e ministres Shekerinska në takimin e Këshillit Euroatlantik të NATO-s në Bruksel;
- Vizitë zyrtare në Shqipëri;
- Pjesëmarrje e ministres Shekerinska në takimin e vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut në Mal të Zi;
- Dërgimi i rotacionit të ri të oficerëve në komandën Veri në misionin Përkrahje vendimmarrëse në Afganistan;



- Vizitë zyrtare në Slloveni;
- Dërgimi i pjesëtarëve të ARM-së në stërvitjen “Saber Guardian” 17;
- Betimi i ushtarëve- vullnetarë në Veles; dhe
- Hapja e projektit ndërkombëtar të sigurisë “Kampi veror”.

Mbi 40 takime me

- Sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg;
- Ndihmës sekretari gjeneral i NATI-s, Taçen Ildem;
- Kryetarin i Sllovenisë, Borut Pahor;
- Ministren e mbrojtjes të Shqipërisë, Mimi Kodheli;
- Ministrin e mbrojtjes të Bullgarisë, Krasimit Karakaçanov;
- Ministren e mbrojtjes të Sllovenisë, Andreja Katiq;
- Ministrin e mbrojtjes të Rumanisë, Adrijan Cucujanu;
- Kryetarin e Këshillit të Evropës, Donald Tusk;
- Përfaqësuesen e lartë për politikë të përbashkët dhe siguri të jashtme të Bashkimit Evropian dhe nënkryetare e Komisionit Evropian, Federika Mogerini;
- Komisaren për politikë evropiane të fqinjësisë dhe bisedimeve për zgjerim, Johanes Han;
- Shefin e zyrës për lidhje të NATO-s në Shkup, Gorazd Bartol;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të ARM-së, gjeneral nënkolonelin, Metodija Veliçkovski;
- Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të forcave të armatosura austriake, gjeneralin Otmar Komenda;
- Kryesinë e sindikatës së Mbrojtjes;
- Familjet e ushtarëve të rënë;
- Përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Maqedonisë;
- Këshilltarin e Mbretërisë së Bashkuar me qëllim të përkrahjes për bashkëpunim të dokumenteve strategjike, Stiven Glover; dhe
- Ambasadorët e 22 shteteve të akredituar në Republikën e Maqedonisë.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

(zëvendëskryetari i Qeverisë dhe ministër i punëve të brendshme Oliver Spasovski)

Ministria e Punëve të Brendshme filloi me realizimin e planit të veçantë për rritjen e sigurisë në komunikacion dhe zonën e kryeqendrës, nëpërmjet kontrolleve të përforcuara dhe intensive të qarkullimit, me fokus të veçantë ndaj kategorisë së shoferëve të rinj, si dhe motoçiklistëve. Gjithashtu, u hap edhe stacioni i bazës në Repartin Policor Rostushe për fotografim për dokumente personale. Ministria nënshkroi Memorandum për mirëkuptim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Hungarisë - Shkollën policore për zbatimin e ligjit- Segedin për bashkëpunim me trajnime të përbashkëta, si dhe angazhim profesional me CEPOL, hartoi edhe aktet juridike për implementimin e Qendrës Nacionale Koordinuese për luftën kundër krimit të organizuar, filloi reformën në seksionin për luftën kundër korrupsionit në MPB dhe defini modelin dhe kornizën ligjore për mekanizmin e jashtëm mbikëqyrës të policisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Avokatit të Popullit. Ministria hartoi Propozim- ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohshme në përputhje me rekomandimet e ekspertit të KE. Nëpërmjet përfaqësuesve të saj realizoi mbi 40 takime me sindikatën dhe ushtarët profesionist, përfaqësues të institucioneve shtetërore jashtë vendit, institucionet ndërshtetërore dhe ambasadorë të akredituar në RM, organizoi Super Kupën e UEFA-s dhe mori pjesë në pesë evenimente, ndër të cilat edhe vizita e Agjencisë të Bashkimit Evropian për trajnime për zbatimin e ligjit- CEPOL në Budapest, ku u nënshkrua angazhim profesional ndërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme dhe CEPOL.

Reforma

- U nënshkrua Memorandumi mirëkuptimi mes Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë- Qendra për trajnime dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Hungarisë- Shkolla policore për zbatimin e ligjit- Segedin për bashkëpunim në fushën e trajnimeve të përbashkëta;
- U nënshkrua Marrëveshje pune mes Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe CEPOL;
- U hap stacioni bazë për fotografim të dokumenteve personale të vendosur në QP Rostushe;
- Filloi realizimi i planit të veçantë për rritjen e sigurisë të qarkullimit në zonën e kryeqendrës, nëpërmjet kontrolleve të përforcuara intensive të qarkullimit, me fokus të veçantë ndaj shoferëve më të rinj, si dhe motoçiklistëve;
- U furnizua me 15 furgona për Njësinë e shpërndarjes (veprimi) së shpejtë;
- **U definua model dhe kornizë ligjore për mekanizëm të jashtë mbikëqyrës të punës së policisë në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Avokatit të Popullit (3-6-9);**
- **U hartuan akte ligjore për veprimin operativ të Qendrës Kombëtare Koordinuese për Luftë kundër Krimit të Organizuar (3-6-9);**
- **U miratua vendim i Qeverisë për formimin dhe emërimin e anëtarëve të Komitetit Kombëtar për tu kundërvënë ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që qon drejt terrorizmit (3-6-9);**
- **U miratua vendim i Qeverisë për emërimin e Koordinatorit Kombëtar për parandalim të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit dhe zëvendësve të tyre (3-6-9);**
- Filloi reforma në Seksionin për të luftuar korrupsionin në MPB (3-6-9);
- **U formua ekipi negocues dhe filluan bisedime për Marrëveshjen statusore me Agjencinë Evropiane për roje kufitare dhe bregdetare (3-6-9); dhe**
- **U iniciuan takime teknike me KE për harmonizimin e sistemit nacional me kërkesat relevante të BE-së dhe Rregullat e Shengejtit (3-6-9).**



Ligjet

- **U hartua Propozim- ligji për azil dhe mbrojtje të përkohshme në përputhje të rekomandimeve të ekspertëve të KE-së (3-6-9).**

Gjashtë ngjarje

- Pjesëmarrje në organizimin final të Super Kupës së UEFA-s, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve për ruajtjen e gjendjes të qëndrueshme të sigurisë, rendit dhe qetësisë publike, si dhe garantimin e sigurisë së pjesëmarrësve në gara, përfaqësuesit e UEFA-s dhe tifozëve;
- Vizitë e Agjencisë së Bashkimit Evropian për trajnime për zbatimin e ligjit- CEPOL në Budapest me qëllim të zgjerimit të Marrëveshjes së punës ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Republikës së Maqedonisë dhe CEPOL;
- Vizitë në SPB Shkup;
- Pjesëmarrje në konferencën "Partneriteti publiko- privat në luftën kundër trafikut me qenie njerëzore" në Moskë, Federata Ruse, organizuar nga Përfaqësuesi special dhe koordinatori për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore të OBSE-s, ambasadore Madina Jarbusinova në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Federatës Ruse; dhe
- Pjesëmarrje dhe fjalim rasti nga MARRI Forumi Ministror në Beograd.

Mbi 40 takime me:

- Sindikatën e pavarur të ushtarëve profesionistë;
- Ministrin e Punëve të Brendshme të Hungarisë, d-r Sandor Pinter, për nënshkrimin e Marrëveshjes për bashkëpunim policor, e cila iu dorëzua Ministrit të punëve të brendshme të Hungarisë;
- Ministrin e Sigurisë për Bosnjën dhe Hercegovinën, Dragan Mekitiq, si pjesë delegacionit i udhëhequr nga kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaaev, me çka diskutohet edhe për mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjes mes Republikës së Maqedonisë dhe Bosnje Hercegovinës për udhëtim me letërnjoftim për qytetarët;
- Delegacionin e UNDP-së, e kryesuar nga Luiza Vinton, koordinatorë e përhershme e Kombeve të Bashkuara dhe përfaqësuese e përhershme e UNDP;
- Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Republikës së Turqisë, z. Selami Altinok;
- Anëtarët e grupit punues të formuar në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës "Përforcimin e respektimit të të drejtave të njeriut gjatë veprimtimit policor", në të cilën anëtarë janë përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë, Avokatit të Popullit, gjykatësit në Gjykatën Supreme, ekspertë përfaqësues të sferës shkencore si dhe nga sektori civil, për vendosjen e mekanizmit të jashtëm për kontroll të punës të të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Jashtme me autorizim policor dhe Policisë së Burgjeve;
- Ambasadoren Madina Jarbusinova, përfaqësuesja speciale dhe koordinatorë në luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore në OBSE;
- Sekretaren e përgjithshme të Konventës së Këshillit të Evropës në aksionin kundër trafikimit me qenie njerëzore, Petja Nestorova;
- Koordinatorin nacional për luftën kundër trafikimit me qenie njerëzore të Malit të Zi Zoran Ulama; dhe
- Mbi 30 takime me ambasadorët e akredituar në Republikën e Maqedonisë.

ZËVENDËSKRYETARI I QEVERISË I ANGAZHUAR PËR ÇËSHTJE EVROPIANE

- Bujar Osmani

Sekretariati për Çështje Evropiane, përveç aktiviteteve të shumta, pas disa vitesh pauzë riaktivizojë Komitetin e Punës për Integritet Evropian (KPIE), dhe mbajti takimin e 36-të. Nga ana e Qeverisë u miratua revizioni i Programit Kombëtar për miratimin e legjislatives së Bashkimit Evropian 2017, dokumentin më voluminoz të planit, i cili përcakton procesin e integritetit evropian të Maqedonisë. Gjithashtu, Sekretariati mbajti 4 tribuna dhe një konsultim tematik, si dhe mori pjesë edhe në 3 vizita zyrtare. Zëvendëskryetari i Qeverisë i angazhuar për çështje evropiane, realizoi mbi 53 takime me përfaqësues të institucioneve shtetërore të vendit dhe jashtë vendit, përfaqësues të institucioneve ndërshtetërore dhe organizatave qytetare, si dhe me ambasadorët e akredituar në RM-së.

Reforma

- Pas disa vitesh pauzë riaktivizojë Komitetin e Punës për Integritet Evropian (KPIE), dhe mbajti takimin e 36-të;
- U mbajt trajnim për plotësimin e aplikimeve për Kornizën investuese në kuadër të Ballkanit Perëndimor;
- U miratua revizioni i Programit Nacional për miratimin e legjislatives së Bashkimit Evropian 2017, me dokumentin më voluminoz të planit, i cili përcakton procesin e integritetit evropian të Maqedonisë;
- U bë thirrje e hapur për propozime- projekteve me ndihmën e Mbretërisë së Norvegjisë në më shumë sfera;
- U bë thirrje e hapur për bashkë-financim të projekteve infrastrukturore “Korniza investuese për Ballkanin Perëndimor” (Western Balkans Investment Framework – WBIF) për vitin 2017 në sektorin e: energjetikës, transportit, mjedisit jetësor dhe politikës sociale deri në fund të nëntorit të vitit 2017;
- U siguroa grant për ndihmë teknike për rehabilitimin e shtëpive ndëshkuese korigjuese;
- U nënshkrua marrëveshja financiare për IPARD 2014-2020;
- U lidhën 14 marrëveshje për përkrahjen e procesit të EU- integritimeve;
- U iniciuan propozime për përforcimin e koordinimin sektorial, shfrytëzimin e IPA dhe PLANIT MASTER me përkrahje të projektit;
- U finalizua programimi vjetor për IPA 2017;
- U paralajmërua fillimi i procesit të programimit IPA 2018-2019;
- U fitua autorizim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të KNIPA (Koordinatori nacional IPA) për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, për financimin në raport me Programin operativ disavjeçar “Zhvillimi rajonal” për ndihmë nga Komuniteti për instrumentin për ndihmë para- aderuese në kuadër të komponentit “Zhvillim rajonal”;
- U fitua autorizim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë të KNIPA për nënshkrimin e Marrëveshjes financiare për Programin aksional për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Shqipërisë për vitin 2015-2017, për alokimin për vitin 2017- IPA 2017/038-164;
- U nënshkrua Marrëveshja për plotësimin e projektit për ndërtim të godinës së përbashkët Bellanocë Stançiq, në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar me Kosovën;
- U përkthyen 867 faqe autoriale nga gjuha angleze në gjuhën maqedonase dhe 106 faqe autoriale nga gjuha maqedonase në gjuhën angleze.



Shtatë ngjarje

- U mbajt tribuna “IPA: PASQYRA DHE GJENDJA” – Avancimi i thithjes të IPA mjeteve” me 300 përfaqësues të organizatave qytetare;
- U mbajt tribuna me përfaqësuesit e sektorit civil për implementimin e Planit 3-6-9;
- U mbajt prezantimi i Planit 3-6-9 para ambasadorit të BE-së Samuel Zhbogar dhe ambasadorëve të vendeve anëtare të BE-së;
- U mbajtën konsultime tematike me përfaqësuesit të organizatave qytetare “EU integrimet duhet të na bashkojnë të gjithëve”, së bashku me kryetarin e Qeverisë Zoran Zaev;
- Pjesëmarrje në komemoracion me rastin e vdekjes të ish kryeministrit të Kosovës, Bajram Rexhepi; dhe
- U realizua vizitë, bashkërisht me Ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Lju-pço Nikolovski për projektin e realizuar me sukses nga mjetet IPA, komponenti nr.5 IPARD 23007-2013, projekt për modernizimin dhe pajisjen e Laboratorit fito -sanitar të Institutit të Bujqësisë.

Mbi 53 takime me:

- Ministrin e punëve të jashtme të Greqisë, Nikos Kocias për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve, të cilat u hapën me impulsin e ri politik në marrëdhëniet me fqinjët, që solli Qeveria e re;
- Dy takime me Mihael Rot, ministrin shtetëror për Evropën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë;
- Zëvendëskryetarin e Qeverisë së Bullgarisë i angazhuar për EU- fondet dhe politikën ekonomike, Tomislav Donçev;
- Zëvendësministrin e punëve të jashtme i Republikës së Estonisë, i angazhuar për çështje evropiane, Matii Masikas;
- Drejtorin e përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme për zgjerim dhe politikë të fqinjësisë Kristijan Danielson, së bashku me Ministrin e drejtësisë Bilen Saliji dhe Ministrin e shoqërisë informatike dhe administratës Damjan Mançevski;
- Përfaqësuesen e lartë për politikë dhe siguri të jashtme të BE- së Federika Mogerina, me delegacionin e Republikës së Maqedonisë të kryesuar nga kryeministri Zaev;
- Dy takime me komisararin për zgjerim, Johanes Han;
- Kryetarin e Këshillit të Evropës, Donald Tusk;
- Sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në delegacionin e Republikës së Maqedonisë të kryesuar me kryeministrin Zaev;
- Nikolla Bertolini, përgjegjës për bashkëpunim në Delegacionin i Bashkimit Evropian në Shkup (DBE) për gjendjen lidhur me realizimin e projektit dhe thithjen e IPA fondeve;
- Drejtoreshën për Evropën Kontinentale në Ministrinë e Jashtme të Francës, Florens Manzhin;
- Kryetarin e Republikës së Maqedonisë, Gjorgje Ivanov, të cilit iu prezantua Plani 3-6-9;
- Ministrin e punëve të brendshme, Oliver Spasovski;
- Ministrin e drejtësisë, Bilen Saliji, me rastin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në Agjencinë për të Drejtat Fundamentale (FRA) të Bashkimit Evropian, proces i cili filloi që në vitin 2008, kur edhe formalisht si shtet kemi kërkuar anëtarësimin në këtë Agjenci;
- Ministrin e shoqërisë informatike dhe administratës, Damjan Mançevskin;
- Përfaqësuesit e Komisionit Shtetëror Zgjedhor;
- Përfaqësuesit e institucioneve kompetente të Republikës së Maqedonisë dhe drejtoritë e përgjithshme kompetente të KE-së për koordinim pas mbajtjes së takimit të trembëdhjetë të Nën-komitetit për tregti, industri, dogana dhe tatim;
- Përfaqësuesit e institucioneve në kompetencat e të cilit është implementimi i masave për gjyqësorin të parapara me Planin 3-6-9, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë;

- Kryetarin e Komisionit për mbrojtje të së drejtës dhe aksesit të lirë të informacioneve me karakter publik, Gjorgji Sllamkov, i përkushtuar për implementimin e masave të Planit 3-6-9, dhe të cilat janë nën kompetencat e Komisionit;
- Avokati Popullit, Ixhet Memeti;
- Shefja e misionit mbikëqyrës të OBSE/ODIHR për zgjedhjet e fundit parlamentare, Kajetana De Zulueta;
- Aleksandar Kalvajt, udhëheqës për bashkëpunim ndërkombëtar në Fondacionin Fridrih Hebert;
- Lars Hansel, përgjegjës në Sektorin për Evropën në Konrad Adenauer;
- Andreas Gis, drejtorin e Drejtorisë për zhvillim të bashkëpunimit në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim;
- Kristof Bajer, nënkryetar i Bordit Drejtues në GIZ (Agjencia gjermane për zhvillim ndërkombëtar);
- Përfaqësuesin i UNICEF-it në Republikën e Maqedonisë, Bexhamin Perks;
- Koordinatorja e përhershme e UNDP dhe përfaqësuese e Kombeve të Bashkuara, Luiza Vinton;
- U organizua mëngjes zyrtar me ambasadorët dhe përfaqësuesve të tyre, në vendet e Ballkanit Perëndimor- Republikës së Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Republikës së Kosovës, Republikës së Malit të Zi dhe Republikës së Serbisë;
- Ambasadorin e Zvicrës, Sibel Suter Tejada;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, Valter Plomp;
- Ambasadorin e Hungarisë, Laslo Ishtven Duks;
- Ambasadorin e Republikës së Italisë, Karlo Romeo
- Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës, Ramon Abaroa Karanza;
- Ambasadorin e Republikës së Polinisë, Jacek Stefan Multanovski;
- Ambasadorin e Republikës së Greqisë, Domitrios Jankakis;
- Ambasadorin e Republikës Kroate, Danijela Barishiq;
- Ambasadorin e ShBA-së, Xhes Bejli;
- Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Maqedoni, Samuel Zhbogar;
- Ambasadorin e Republikës së Austrisë, Renate Kobler;
- Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Fatos Reka;
- Ambasadorët e vendeve anëtare të BE-së, në udhëheqje të kryetarit të Qeverisë z. Zaev;
- Dy takime me ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ciklin e rregullt i takimeve, në përputhje me mekanizmin e vendosur monitorues për ndjekjen në obligimeve nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) me KE;
- Këshillin për Stabilizim dhe Asociim (Këshilli për SA), ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe BE-së në nivel më të lartë të bashkëpunimit institucional mes dy palëve, diskuton në nivel vjetor, në nivel të ministrave të punëve të jashtme; dhe
- Takimi i 14-të me Komitetin për Stabilizim dhe Asociim mes Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian (KSA) u mbajt më 29 qershor të vitit 2017 në Bruksel.



ZËVENDËSKRYETARI I QEVERISË I ANGAZHUAR PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE

- d-r Koço Angjushev

Zëvendëskryetari i Qeverisë për çështje ekonomike d-r Koço Angjushev, së bashku me ekipin e tij, hartoi nismën për rikthimin e tarifës së lirë të energjisë elektrike dhe filloi me hartimin e modelit të ri për përkrahjen e investitorëve për zhvillim më të fuqishëm ekonomik, nëpërmjet trajtimit të barabartë të investitorëve të vendit dhe të huaj. Gjithashtu filloi me hartimin e tri zgjidhjeve ligjore, atë të ndryshimit të afatit për paraqitje të regjistrimit të së drejtës së patundshmërisë dhe për evidentimin e të dhënave nga librat intabulacionit të Kadastrës për patundshmërisë, Propozim- ligjin të Energjetikës dhe Propozim- ligjin për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për eksport, import dhe transit të mbeturinave.

Reforma

- Nisma për rikthimin e tarifës së lirë të energjisë elektrike;
- **Vendim i Qeverisë për zbardhjen e marrëveshjeve për ndarjen e ndihmës shtetërore për investitorët e huaj (3-6-9);**
- Analizë e hollësishme për efektet e zbatimit të deritanishëm të politikave për tërheqje të investimeve të huaja;
- Vendimi i Qeverisë për formimin e turpit koordinues për bashkëpunim të investitorëve të huaj me kompanitë e vendit;
- Proces i hartimit të modelit të ri për përkrahje të investitorëve për zhvillim më të fuqishëm ekonomik nëpërmjet trajtimit të barabartë të investitorëve të vendit dhe të huaj;
- Hartimi i projektit për subvencionim qeveritar të ndërtimit të 20MW elektranës foto- valtaike; dhe
- Shqyrtimin e opsioneve për pavarësi energjitike, me çka do të kthehet siguria dhe qëndrueshmëria energjitike në Republikën e Maqedonisë.

Ligjet

- Hartimin e Propozim- rregullores për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për eksport, import, transit të mbeturinave;
- Hartimin e Propozim- ndryshimit të Ligjit për ndryshim të afatit për paraqitje për evidentim të të drejtave për patundshmëritë dhe evidentim të të dhënave nga librat e intabulacionit të Kadastrës për patundshmërisë; dhe
- Hartim të Propozim- ligjit për energjitikë i cili do të harmonizohet me Pakon e tretë energjitike, e ndër-marrë si obligim i Bashkësisë energjitike.

Takime

- Me të gjithë investitorët e huaj aktiv dhe të gjithë investitorët potencial.

ZËVENDËSKRYETARI I QEVERISË I ANGAZHUAR PËR IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJES KORNIZË DHE SISTEMIT POLITIK

- Hazbi Lika

Zëvendëskryetari i Qeverisë për implementimin e Marrëveshjes Kornizë dhe sistemit politik, Hazbi Lika, hartoi Propozim- ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe është dërguar në procedurë kuvendare. Realizoi mbi 12 takime dhe mori pjesë në 16 vjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Ligjet

- Propozim- ligjin për përdorimin e gjuhëve (3-6-9)

Një eveniment

- 16 vjetorin e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Mbi 12 takime me:

- Ambasadorin e Republikë së Shqipërisë, Fatos Reka;
- Shefen e Misionit të OSBE-së, Nina Soumalinen;
- Ambasadorin i Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ambasadorin e Britanisë së Madhe, Çarls Gareth;
- Ambasadoren e Konfederatës Zvicerane, Sibil Suter Tejada;
- Ambasadoren e Republikës së Kroacisë Daniela Barishiq;
- Ambasadoren e ShBA-së Xhes Bejli; dhe
- Zëvendës - ambasadorin e Italisë, Fabio Kristijani



MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

(ministër Nikolla Dimitrov)

Janë ndërmarr aktivitete intensive diplomatike për përforcimin e pozitës së lëkundur të Republikës së Maqedonisë në skenën ndërkombëtare, me të cilat Maqedonia doli nga izolimi. Ministri i punëve të jashtme realizoi 13 takime brenda dhe jashtë RM-së me ministrat e punëve të jashtme, ambasadorët dhe përfaqësues të tjerë të huaj dhe përfaqësues të sektorit civil, me të cilët ripërtëriu miqësinë me vendet e botës, por edhe dialogun e BE-së nga e cila pritet rekomandim i pastër dhe pakusht për fillimin e bisedimeve para-aderuese siç u theksua nga shefja e diplomacisë evropiane Mogerini edhe nga komisarja Han. Gjithashtu, pas dy vitesh pauzë, u mbajt takimi i 13-të i Këshillit për Stabilizim dhe Asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, derisa NATO Republikën e Maqedonisë e sheh si “partner të rëndësishëm”, në realizimin e misionit të tyre. U nënshkrua Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Republikën e Bullgarisë, ndërkaq ministri i punëve të jashtme të Greqisë, Nikos Kocias, theksoi se është “shumë i kënaqur për rezultatet pozitive nga masat e përbashkëta të fqinjësisë së mirë”. Në drejtim të transparencës dhe hapjes së Ministrisë së Punëve të Jashtme, të gjitha dokumentet lidhur me udhëtimet zyrtare të të punësuarve në MPJ, sërish u bënë informacione me karakter publik. U firmos edhe Protokoll me Qeverinë e Republikës së Kosovës për pikën kufitare të përbashkët Bellanocë- Stançiq, si dhe deklarata për bashkëpunim me Mbretërinë e Suedisë dhe Mbretërinë e Norvegjisë. MPJ organizoi konferencën “Republika e Maqedonisë drejt anëtarësimit të plotë në NATO”, kurse me përfaqësuesit e nga Ministria mori pjesë në gjashtëmbëdhjetë evenimente, ndër të cilat edhe në Takimin për Procesin “Brdo Brioni”, Forum Global në Varshavë, Samitin e NATO-s në Podgoricë dhe Samitin e Ballkanit Perëndimor në Trieste.

Reforma

- Me vendim të Ministrit për punë të jashtme, **dokumentet lidhur me udhëtimet zyrtare të MPJ-së sërish janë informacione me karakter publik (3-6-9)**

Lidhje bashkëpunimi

- U firmos Protokoll ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për pikën kufitare të përbashkët Bellanocë- Stançiq;
- U nënshkrua deklarata për bashkëpunim ndërmjet Mbretërisë së Suedisë dhe Mbretërisë e Norvegjisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe
- Deklaratë e përbashkët për partneritet dhe bashkëpunim ndërmjet Mbretërisë së Norvegjisë dhe Republikës së Maqedonisë.

Shtatëmbëdhjetë evenimente

- Konferenca “Republika e Maqedonisë drejt anëtarësimit të plotë në NATO”, e organizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme;
- Pjesëmarrje e ministrit Dimitrov në takimin e Procesit “Brdo-Brijuni”;
- Pjesëmarrje e drejtorit për punë konsullore në MPJ, Zvonimir Popoviq në takimin e Komisionit kufitar të përhershëm të përzier ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë;
- Pjesëmarrje e ministrit Dimitrov në Forumin tradicional në Dubrovnik, i titulluar “Bashkëpunimi dhe siguria Adriatiko- mesdhetare në Evropën Juglindore”;
- Pjesëmarrje e ministrit Nikolla Dimitrov në Forumin Global në Varshavë në bashkë-organizim të Këshillit Atlantik dhe Institutit të Polonisë për Marrëdhënie Ndërkombëtare;

- Pjesëmarrje zëvendësministrit për punë të jashtme të takimit joformal të ministrave për punë të jashtme në vendet anëtare të OSBE-s;
- Pjesëmarrje e ministrit Dimitrov në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Triestë;
- Pjesëmarrje e ministrit Dimitrov në takimin e trembëdhjetë të Këshillit për Stabilizim dhe Asociim, ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian;
- Pjesëmarrja e ministrit Dimitrov në Samitin e NATO-s në Podgoricë, si pjesë e delegacionit të kryetarit Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev;
- Takimi i gjashtë për masat e ndërtimit të besimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë;
- Takim i dytë në Komitetin të përbashkët drejtues për Kornizën për zhvillim të bashkëpunimit me Kombet e Bashkuara, me titull "Partneriteti për zhvillim të qëndrueshëm" Strategjia e OKB-së për 2016-2020";
- Fjalimi i ministrit Dimitrov para Komisionit për politikë të jashtme të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë;
- Fjalimi i ministrit Dimitrov para përfaqësuesve të institucioneve të BE-së, vendeve anëtare të BE-së, grupeve "Think-tank", të cilat merren me politikën evropiane dhe akademitë në Bruksel;
- Vizita e grupit me më shumë se 20 studentë në Shkollën e lidërshiptit Mandel, të ftuar të Akademisë Diplomatike në MPJ; dhe
- Vizita e studentëve nga "Trieste School of Management", Trieste, Itali.

Mbi 80 takime me:

- Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë, d-r Millan Jazbec;
- Ambasadoren e Republikës së Kroacisë, Daniela Barishiq;
- Bordin Ekzekutiv të Sindikatës së Shërbimit Diplomatik Maqedonas;
- Ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ambasadorin e Bashkimit Evropian, Samuel Zhbogar;
- Ambasadorin e Republikës së Sllovakisë, Martin Bezak;
- Ambasadorin e ShBA-së në Republikën në Maqedoni, Xhes Bejli;
- Kryeministrin e Republikës së Bullgarisë, Bojko Borisov;
- Ambasadoren e Republikës së Turqisë, Tulin Erkal Kara;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, Valter Ploump;
- Ambasadorin e Republikës së Italisë në Republikën e Maqedonisë, Karlo Romeo;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Norvegjisë në Republikën e Maqedonisë, Arne Sanes Bjornstad;
- Ministrin e punëve të jashtme të Mbretërisë së Hollandës, Bert Kunders;
- Ministrin e punëve të jashtme në Republikën e Greqisë, Nikos Kocias;
- Presidentin e Republikës së Greqisë, Prokopis Pavopulos;
- Përfaqësuesin e lartë të Demokracisë së Re në Republikën e Greqisë, Jorgos Kumucakos;
- Ambasadorin e Federatës Ruse në Republikën e Maqedonisë, Oleg Shçerbak;
- Shefen e Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, Nina Suomalainen;
- Ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Turqisë, Melut Çavushoglu;
- Ambasadoren e Republikës së Australisë, Xhulija Fini;
- Ambasadoren e Republikës Popullore të Kinës, N.E. Jin Lisjen;
- Shefen e Misionit Mbikëqyrës së OBSE-s për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Maqedoni, Tana De Zulueta;
- Ambasadoren e Republikës së Austrisë në Republikën e Maqedonisë, Renate Kobler;



- Ambasadoren e Mbretërisë së Bashkuar, Çarls Garet;
- Ministrin e punëve të jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë, Borge Brende;
- Presidentin e Republikës së Serbisë, Aleksandar Vuçiq;
- Ekspertin e lartë të Bashkimit Evropian, Rajhard Pribe;
- Ambasadoren e Malit të Zi, Predrag Mitroviq;
- Ambasadoren e Republikës së Polonisë, Jacek Mulatovski;
- Drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e përgjithshme për politikë fqinjësore dhe bisedime për zgjerim të Komisionit Evropian, Xhenova Luiza Kalavera;
- Ambasadorin e Japonisë, Keiko Haneda;
- Ambasadoren e Bosnje dhe Hercegovinës, Lepa Babiq;
- Ambasadorin e Hungarisë, Laslo Ishtavan Duks;
- Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Fatos Reka;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës, Ramon Abaroa;
- Zëvendës ndihmës sekretarin e shtetit të ShBA-ve për Evropën dhe Euro-Azinë, Hojt Brajan Ji;
- Deputetin special i OKB-së për bisedimet me emrin, ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë, Metju Nimic;
- Shefin e Zyrës për lidhje të NATO-s në Shkup, kapiteni i Marinës Gorazd Bartol;
- Drejtoreshën për Evropën Kontinentale në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës, Florens Manzhebn;
- Përfaqësuesit e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- Përfaqësues të UNICEF-it në Maqedoni, Benxhamin Perks;]
- Koordinatorin rezident të OKB-së në Maqedoni, Luiza Vinton;
- Ambasadorin e Republikës Islamike, Hosein Karimi;
- Ambasadorin e Greqisë, Dimitris Janakakis;
- Ambasadoren e Republikës së Serbisë, Dushanka Divjak- Tomiq;
- Ministrin e punëve të jashtme të Polonisë, Vitold Vashçikovski;
- Ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Australisë, Sebastian Kurc;
- Ambasadorin e Holandës, Vuter Plomp;
- COREPER ambasadorët dhe përfaqësuesit e përhershëm të vendeve anëtare në Bruksel;
- Zëvendëskryeministri dhe ministër i Mbretërisë së Belgjikës, Didie Rejnders;
- Ambasadorin i Finlandës, Perti Ikonen;
- Ambasadorin i Kanadasë, Filip Pingleton;
- Zëvendësministrin e punëve të jashtme të Republikës së Estonisë, i angazhuar për çështje evropiane, Matti Maasikas;
- Ndihmës sekretari shtetëror i NATO-s për diplomaci publike, Taëan Ildem;
- Ambasadorin i Izraelit, Dan Orian;
- Ambasadorin i Konfederatës së Zvicrës, Sibil Suter, Tejada;
- Ministrin e punëve të jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati;
- Drejtoreshën për Ballkanin Perëndimor në Forin dhe Komonvelt Ofis në Mbretërinë e Britanisë së Madhe dhe Irlandën Veriore, Fiona Mek Ilvam;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Suedisë, Mats Stefanson;
- Ambasadorin e Republikës së Azerbajxhanit, Faig Bagirov;
- Përfaqësuesit e fondit të hapur rajonal për Evropën Juglindore, Insitutin Nacional Demokratik-Maqedoni dhe Institutin për Politikë Evropiane;

- Kryetarin dhe drejtorin ekzekutiv të Eurothink, Andreja Stojkovski dhe Ljupço Petkovski;
- Zëvendëskryetaren e Qeverisë dhe ministren e punëve të jashtme të Republikës së Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva;
- Ministri shtetëror i Katarit, Al Muraiki;
- Delegacionin e Emirateve të Bashkuara Arabe;
- Ministrin e punëve të jashtme të Mbretërisë së Danimarkës, Anders Samuelsen;
- Ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Finlandës, Timo Soini;
- Ambasadorin e RF të Gjermanisë, Tomas Norberg Gerbrih;
- Përfaqësuesin e Organizatës Botërore të Shëndetit, D-r Zhihan Tavila;
- Ambasadorin e Republikës Arabe Egjipt, Minal Jaehia El Shinavi;
- Hans Van Balen, anëtar i Parlamentit Evropian dhe kryetar i Aleancës së Liberalëve dhe Demokratëve të Evropës;
- Zëvendëskryetar i Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe ministrit të punëve të jashtme, Ivica Daciq;
- Kryetarin e Këshillit të Evropës, Donald Tusk;
- Përfaqësuesen e lartë për politikë të jashtme dhe siguri të Bashkimit Evropian dhe nënkryetare e Komisionit Evropian, Federika Mogherini;
- Komisarin evropian për politikë të fqinjësisë dhe bisedimeve për zgjerim, Johanes Han;
- Sekretarin e përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg;
- Sekretarin shtetëror për çështje evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Gjermanisë, Mihael Rot; dhe
- Ambasadorin gjerman, Kristine D. Althauzer.



MINISTRI I FINANCAVE

(ministri Dragan Tevdovski)

Nëpërmjet rebalancimit të buxhetit u shkurtuan harxhimet joproductive: reklamat, harxhimet për Shkupin 2014, udhëtimet zyrtare, reprezentacionet, automobilat etj. ndërkaq janë paraparë më shumë para për shëndetësinë, për mbrojtjen sociale dhe për masat aktive të punësimit. Gjithashtu, janë paraparë mjete për masat për përkrahej të qytetarëve dhe kompanive të vendit, si dhe rritjen e pagës minimale, zgjidhje të problemit të punonjësve të falimentuar, **heqjen e taksës së radio-difuzionit (3-6-9)**, përkrahje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe bujqve si dhe pushim vjetor për punëtorët me paga të ulëta. Me qëllim të informimit transparent të qytetarëve, Ministria e Financave publikoi Buxhetin e Qytetarëve, si dhe analizën të ardhurave të përfitimit të pabarabartë, e cila është hartuar për herë të parë që nga pavarësimi i Maqedonisë. Përveç të raporteve të reja dhe publikimin e raporteve të rregullta, Ministria avancoi përmbajtjen dhe formatin e raporteve aktuale. Janë bërë ndryshime të katër ligjeve, edhe atë Ligjit për kontabilitetin e buxhetit dhe shfrytëzuesve të buxhetit, për realizimin e Buxhetit të vitit 2017, për dhënien e obligacioneve të Republikës së Maqedonisë dhe denacionalizimin, si dhe ndryshime në drejtim të avancimit të procesit buxhetor dhe transparencës më të madhe. Reflektimi më i shpejt dhe më i mirë i përcaktimit të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë për shërbimin e rregullt të obligimeve dhe kthimin e borxhit ndaj ekonomisë, paraqet kthimi i TVSh-së. Që nga fillimi i mandatit, kthimi i TVSh-së ishte joselktiv dhe rregullisht arkëtohej në trezor, që injekton likuiditet të kompanive. Gjithashtu, Ministria e Financave në mënyrë aktive menaxhonte me borxhin publik dhe punonte në uljen e frekuencës të kërkesës të letrave shtetërore me vlerë, dhe u lidhën disa marrëveshje me komunat e Maqedonisë. Përfaqësuesit e Ministrisë morën pjesë në tre evenimente dhe realizuan 12 takime me institucionet relevante.

Reforma

- U siguruan mjete për subvencionimin e pagës minimale, me qëllim në shtator paga minimale të rritet dhe të ketë vlerën 12.000 denarë;
- Për politikat dhe masat aktive për përkrahje të punësimeve në sektorin privat, me qëllim të rebalancimit është bërë ridestinimi edhe i 112 milion denarëve dhe ata do të kenë vlerën prej 667 milion denarë;
- Përkrahje për kompanitë e vogla dhe të mesme dhe përkrahje të investimeve vendore grifid prej afro 135 milion denarë deri në fund të vitit;
- Përkrahje për turizmin vendor nëpërmjet subvencionimit me vlerë prej 60 milion denarë, për punëtorët me paga më të ulëta;
- Zgjidhja e sigurimit material të të papunëve, për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese shtetërore, përkatësisht të punëtorëve të falimentuar nga këto ndërmarrje, të cilat deri më tani nuk janë përfshirë me zgjidhjet ekzistuese ligjore;
- Subvencionimin e Radio Televizionit të Maqedonisë me heqjen e taksës së radio-difuzionit dhe lirin e obligimit të qytetarëve nga kjo e dhënë publike;
- Përkrahje të IPA projekteve nga 500 milion denarë për pjesëmarrje të buxhetit dhe tërheqje të donacioneve me qëllim të sigurohet intensifikimi i aktiviteteve të përkrahura nga BE-ja në periudhën para-aderuese, si dhe shfrytëzimin më të madh të fondeve evropiane;
- Publikimi i analizës së të ardhurave të përfitimit të pabarabartë, për herë të parë në Republikën e Maqedonisë;
- Ministria e Financave filloi publikimin e të dhënave për realizimin e të ardhurave dhe mbulimin e harxhimeve nga Buxheti i përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë, në nivel kuartal (të tremujorit);
- Avancimi i përmbajtjes dhe ndryshim i formatit të Raportit për realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për 6 muajt e para, të vitit 2017;

- Hartimin e buletinit të ri statistikor;
- Avancimin e përmbajtjes së Raportit ekonomik tremujor i Ministrisë së Financave;
- Avancimin e përmbajtjes së Raportit mujor të Lëvizjeve afatshkurtra të Ministrisë së Financave;
- Hartimin e plan- informimit për Organizatën ndërkombëtare Open Budget Index;
- Plotësimin e serive kohore për strukturën e borxhit publik, duke filluar nga viti 2008;
- Publikimi i tabelës detale për realizimin e ankandëve të letrave shtetërore me vlerë;
- Qeveria shqyrtoi Raportin vjetor për menaxhimin me borxhin publik të vitit 2016;
- Publikimi i obligimeve të papaguara të institucioneve shtetërore, me datë të përcaktuar 31.05.2017;
- Publikimi i realizimit të buxhetit për NjVL sipas kuartaleve;
- Hartimi i zgjidhjes aplikative me qëllim obligimet e papaguara të evindetohen sistematikisht;
- Hartimi i Buxheti të Republikës së Maqedonisë për vitin 2018 dhe Strategjisë Strategjike Fiskale 2018-2020;
- Dekret për kornizën institucionale nën sistemin për luftën kundër parregullsisve dhe mashtrimeve;
- Frekuencë e zvogëluar i kërkesave të letrave vendore me vlerë, nga 3-4 herë gjatë muajit, 2 herë në muaj; dhe
- Publikimi i kalendarit të ankandëve për K3 dhe K4 të letrave shtetërore me vlerë.

Ligjet

- Propozim- ndryshimi për Ligjin për kontabilitet për buxhetet dhe shfrytëzuesit e buxheti;
- Miratimin e ndryshimit dhe plotësimin të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017 dhe plotësimin e Ligjit për realizimin e Buxhetit për vitin 2017 nga Kuvendi;
- Propozim- ligj për ndryshimin e Ligjit për dhënien e obligacioneve të Republikës së Maqedonisë dhe denacionalizimin; dhe
- Ndryshim të Rregullores ligjore në drejtim të avancimit të procesit buxhetor dhe transparencës më të madhe.

Projekte

- Realizimi i projekteve të cilët dalin nga Ligji për subvencionimin e kredive banesore;
- U lidhën marrëveshje për ndërtimin e çerdhes të fëmijëve në Komunën e Sopishte; dhe
- U lidhën marrëveshje për ndërtimin e rrugëve lokale dhe avancimin e furnizimit të ujit në Komunën Çeshinovë- Obleshevë.

Pagesa

- Pagesa e huamarrjes ndaj Dojçe Bank nga viti 2012 me vlerë prej 77,3 milion euro.



Tri ngjarje

- Pjesëmarrje në Konferencën e Fondit Monetar Ndërkombëtar;
- Takim iniciues për hartimin e Programit për reforma ekonomike për vitin 2018, ku ishin të ftuar dhe morën pjesë përfaqësues të sektorit joqeveritar, universitet, përfaqësues nga institucione ndërkombëtare financiare në Republikën e Maqedonisë; dhe
- Takim konsultues ndërmjet ministrave të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe profesorëve universitar.

Mbi 12 takime me:

- Delegacionin e Komisionit Evropian;
- Ambasadorët e Britanisë së Madhe, Francës, Zvicrës, Holandës, ShBA-s dhe Izraelit;
- Institucionet ndërkombëtare financiare dhe kreditorëve bilateral (Bankës Botërore dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Bankën për Zhvillim në Këshillin e Evropës, KFV); dhe
- Përfaqësuesen e OKB-së dhe koordinatoren e UNDP-së në Maqedoni. Luiza Vinton.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

(ministër Arben Taravari)

Ministria e shëndetësisë promovoi shërbimin “Mirë se vjen bebe”, nëpërmjet të cilit prindërit do të mund të marrin certifikatën e lindjes nga libri amë për vetëm dy ditë, u miratua vendim për uljen e çmimit të vaksinës së meningokokut për pelegrinët që shkojnë në Haxh, në 1000 denarë, dhe kërkoi nga të gjitha institucionet shëndetësore publike të shpalosin me çfarë mungese ballafaqohen sa i përket aparaturave dhe kuadrit, si dhe për shfrytëzimin më efikas të mjeteve buxhetore. U bë modifikimi i udhëzimeve për caktimin e takimit dhe kohëzgjatjen e kontrolleve në institucionet shëndetësore publike. Në proces është hartimi i aplikimit për qasje më të lehtë të bazës me dhuruesve të organeve, por punohet edhe për zgjidhje të re për tejkalimin e problemit të shkaktuar për dhënien e kartelevë elektronike të shëndetësisë. Gjithashtu, hartohet Strategjia Kombëtare disavjeçare në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetit (2020-2030), si dhe Strategjia kombëtare për eliminimin e hepatitit deri në vitin 2030. U miratua vendim për përpunimin e Regjistrit për sëmundjet malinje dhe sëmundjeve të tjera, në vazhdimësi është edhe hartimi për ratifikimin e “Konventës së Stambollit”. U organizuan tre ngjarje për mbylljen me sukses të projektit për transplantimin e organeve, për pastrimin e tërësishëm të Qendrës Klinike dhe për vendosjen e tabelave të reja tri gjuhësore, për orientim në Qendrën Klinike “Nënë Tereza”.

Reforma

- Aprovimin e shërbimit “Mirë se vjen bebe”, nëpërmjet të cilit prindërit do të mund të marrin certifikatën e lindjes nga libri amë për vetëm dy ditë;
- U vazhdua kohëzgjatja e kontrolleve në institucionet shtetërore publike;
- Aktivitete për thjeshtëzimin e shëndetësisë terciare;
- Përpunimin e aplikimit për akses më të lehtë në bazën e dhuruesve potencial të organeve;
- Modifikimi i udhëzimeve për caktimin e kontroll (aprovimin e udhëzimit urgjent dhe pa termin);
- Aktivitete për gjetjen e zgjidhjeve të reja për tejkalimin e problemit të shkaktuar me kartelat elektronike të shëndetësisë;
- Formimi i grupit të punës për zgjidhjen e problemit afatgjatë me mos pagesën e specialistëve;
- Aprovim komplet i ekzaminimeve laboratorike të turnit të tretë në Klinikën e Fëmijëve në Kozle;
- Rritja e kontrollit të harxhimeve për të gjitha institucionet shëndetësore publike;
- Shqyrtohen mundësitë për punësimin e studentëve më të mirë në fakultetin e Mjekësisë, menjëherë pas përfundimit të studimeve;
- Në proces është modifikimi i projektit “Pagesa me kontribut” (dënimet u tërhoqën);
- Tejkallim i suksesshëm i problemit për gjinekolog në Shuto Orizare;
- Është hapur linja telefonike përmes WhatsApp dhe Viber - (#PërshëndetjeTaravari);
- Hartimi i Strategjisë Kombëtare disavjeçare në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetit (2020-2030);
- Realizimi i fushatës në Facebook “Mjeku yt” dhe “Vizioni im”,
- Formimi i grupit të punës për koordinim dhe komunikim më të mirë të organizatave qytetare nga fusha e shëndetësisë;
- U siguroa buxhet për funksionimin e shërbimeve për përkrahje të personave me HIV, përdoruesve të drogave, punonjësve seksual dhe komunitete të tjera të marginalizuara;
- Aktivitet e për heqjen e participit për grupet e rrezikuara sociale;



- Përgatitje për ratifikimin e “Konventës së Stambollit”;
- Prezantimin për revizionit afatmesëm të Strategjisë për shëndet seksual reprodaktiv dhe Plan veprimin për implementim 2017-2020;
- Vendim për hartimin e regjistrit të sëmundjeve malinje dhe sëmundjeve të tjera;
- Abrogimi i vendimit të mëparshëm për rritjen e çmimit të ilaçeve;
- Ulja e çmimit të vaksinës së meningokokut për pelegrinët që shkojnë në Haxh, në 1000 denarë; dhe
- Vendim për sigurim të stafit mjekësor dhe përkrahje profesionale për nevojat e Qendrës për autizëm në bashkëpunim me MPPS.

Ligjet

- Ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje shëndetësore;
- Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ilaçe dhe mjeteve mjekësore; dhe
- Propozim-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për studime mjekësore dhe përsosje në vazhdimësi të doktorëve të mjekësisë

Tri ngjarje

- Përmbyllje e suksesshme e projektit për transplantimin e organeve, ku u ndanë mirënjohje dhe vërtetime për familjet dhurues të organeve;
- Aksion për pastrimin e tërësishëm të Qendrës Klinike; dhe
- Vendosjen e tabelave të reja tri gjuhësore, për orientim në Qendrën Klinike “Nënë Tereza”.

MINISTRIA E DREJTËSISË

(ministër Bilen Saliji)

Republika e Maqedonisë zyrtarisht u bë anëtare e Agjencisë për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian. Hartimi i Strategjisë për reforma në gjyqësi është në fazën përfundimtare, ndërkohë pasojnë dhe aktivitetet për formimin e grupeve të punës të cilat do të punojnë në Propozim- ligjin për informatorët, Ligji për dëshmitarët e mbrojtur dhe Ligji për mbrojtjen e privatësisë. Në procedurë kuvendare për miratimin e Propozim - ligjit për përdorimin e gjuhëve, ndërkaq hartohet edhe ndryshim i Ligjit për verifikimin e fakteve, Ligji për noterë dhe Ligji për përmbarim. Përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë realizuan mbi 15 takime me ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve relevante dhe morën pjesë në shtatë evenimente.

Reforma

- Në fazën përgatitore është formimi i Grupit të punës, i cili do të punojë për Propozim – ligjin për informatorët (3-6-9);
- Përgatitet formimi i Grupit të punës, i cili do të angazhohet për punën e Ligjit të dëshmitarëve të mbrojtur (3-6-9);
- Në proces është formimi i Grupit të punës, që do të punojë në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për mbrojtje të privatësisë (3-6-9);
- U formua Grup i punës për hartimin e Propozim- ligjit për ndryshim të Ligjit për Këshillin gjyqësor të RM-së dhe Ligjit për gjyqësinë (3-6-9); dhe
- Në fazë përfundimtare është hartimi i Strategjisë për reforma në gjyqësi (3-6-9).

Ligjet

- Propozim – ligji për përdorimin e gjuhëve, i cili është në procedurë për miratim (3-6-9);
- Hartimi i Propozim- ligjit për abrogimin e Ligjit për verifikimin e fakteve (3-6-9);
- Hartimi i Propozim- ligjit për ndryshim të Ligjit për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë (3-6-9);
- Hartimi i Propozim – ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për noter; dhe
- Hartohet Propozim- ligj për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim..



Shtatë evenimente

- Takim (brifing) i përbashkët për mediat dhe takim me ministrin Saliji dhe zëvendëskryeministrin për çështje evropiane Buajr Osmanin, me rastin e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë në Agjencinë për Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian;
- Pjesëmarrje në takimin e 14-të të Komitetit për Stabilizim dhe Asocim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian (KSA) në Bruksel;
- Takim koordinues lidhur me Strategjinë për reforma në sektorin e gjyqësorit;
- **Grupi i punës me përfaqësuesit e Grupit të punës për hartimin e Strategjisë për reforma në sektorin e gjyqësorit (3-6-9);**
- Pjesëmarrja e ministrit në Shkollën verore për magjistrat dhe doktorantë në fushën e juridikut dhe shkencave politike në Ohër; dhe
- **Dy takime me anëtarët e Këshillit për reforma në sektorin e gjyqësorit (3-6-9)..**

Mbi 15 takime me :

- Ambasadorin e ShBA-së në Republikën në Maqedoni, Xhes Bejli;
- Përfaqësuesit e Odës së Noterëve të Republikës së Maqedonisë;
- Shefen e Misionit të OSBE-së në Republikën e Maqedonisë, Nina Suomalainen;
- Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Fatos Reka;
- Ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës, Valter Ploump;
- Ekspertin e lartë të Bashkimit Evropian, Rajhard Pribe;
- Ambasadoren gjermane të Republikës Federale të Gjermanisë. Sh.S. d-r. Kristine D. Althauzer.
- Kryetarin e Shoqatës së Gjykatësve të Republikës së Maqedonisë, d-r Xhemali Saiti
- Ambasadoren e Mbretërisë së Bashkuar, Çarls Geret;
- Kryetarin e Sindikatës së punëtorëve nga drejtoria, organet gjyqësore dhe shoqatës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, Pece Grujovski;
- Ambasadoren e Republikës së Kroacisë, Daniela Barishiq;
- Prokuroren Rej Vuds, këshilltare juridike nga Ambasada e ShBA-së në Shkup;
- Përfaqësues të UNICEF-it në Maqedoni, Benxhamin Perks;
- Ambasadorin e Republikës së Italisë në Republikën e Maqedonisë, Karlo Romeo;

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE

(ministër Goran Sugareski)

Ministria e Transportit dhe Lidhjeve deri më 50% uli çmimet për shërbimet e Kadastrës dhe nënshkroi marrëveshje për themelimin e komunitetit transportues, si dhe ndërtimin e rrugës ekspres nga Gradsko deri në Drenovë, për të cilën janë siguruar 35,4 milion euro, grant nga BE-ja. Gjithashtu, janë siguruar mjete për ndërtimin e hekurudhës drejt Republikës së Bullgarisë si pjesë e Korridorit 8, hekurudha Manastir- Kremnica, qarku rrugor nga Prilepi deri në Raec, si dhe mjete për avancimin e furnizimit me ujë të komunës së Gjevgjelisë, Gostivarit dhe Kavadarit. Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve promovoi tri linja të reja me buxhet të ulët nga Wizz Air, si dhe linjën ajrore Doha – Shkup të Qatar Airways.

Reforma

- U miratua revidimi i Programit operativ për transport 2014-2020; dhe
- Ulja e kostos së shërbimeve të Kadastrës deri më 50% dhe rikthim të disa nga kompanitë e autorizuar të gjeodezisë..

Propozim- ligji

- U miratua Propozim- ligji për ndryshim të Ligjit për veprim të objekteve të ndërtuara pa leje.

Dy evenimente

- Promovimi i tri linjave ajrore me buxhet të ulët nga Wizz Air;
- Promovim i linjës ajrore Doha- Shkup nga Qatar Airways.

Marrëveshje të lidhura

- Memorandum bashkëpunimi për lidhje hekurudhore me Republikën e Bullgarisë;
- U nënshkrua Marrëveshje për themelimin e komunitetit transportues të Samitit në Trieste; dhe
- U nënshkrua Marrëveshje bilaterale për ndërtimin e rrugës ekspres nga Gradsko deri në Drenovë me të cilën janë siguruar 35,4 milion euro grant nga BE-ja.

Tjetër:

- U siguruan 70 milion euro grant nga VBIF për ndërtimin e hekurudhës drejt Republikës së Bullgarisë si pjesë e Korridorit 8;
- U siguruan mjete për ndërtimin e hekurudhës Manastir- Kremnicë dhe në procedurë është përzgjedhja e kontraktuesit;
- U siguruan 9,5 milion euro grant për avancimin e furnizimit me ujë të Komunës së Gostivarit, Kavadarit dhe Gjevgjelisë prej të cilave 4,5 milion janë grant nga SEKO- Zvicra dhe 5 milion euro grant nga KFW; dhe
- U siguruan mjete për financimin e qarkut rrugor nga Prilepi deri në Raec.



MINISTRIA E EKONOMISË

(ministër Kreshnik Bekteshi)

Ministria e Ekonomisë riktheu tarifën e lirë të energjisë elektrike, aprovoi masën e re prej 60 milion denarë për përkrahje të turizmit vendor për qytetarët me të ardhura të ulëta, filloi me arkëtimin e kuponëve për pushim të punëtorëve me të ardhura të ulëta dhe me pagesën për unifikimin e vitrinave në Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Ministria e Ekonomisë hartoi propozim-ligjin për energjetikë, si dhe ndryshimin e katër ligjeve të tjera me të cilët propozohet abrogimi i procedurës doganore për regj lëkurë, lista e mallrave për gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2017, ndryshime në kategorizimin e objekteve të hotelarisë dhe plotësimin e Ligjit për automjetet. Përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë realizuam mbi 10 takime me përfaqësuesit e sektorit të biznesit, shoqatave dhe ambasadave, morën pjesë në 5 evenimente, ndërkaq me rastin e Ditës së Minatorëve 28 gusht 2017, u ndanë pllakate dhe mirënjohje 18 minatorëve më të spikatur, gjashtë shoqatave dhe institucioneve për kontribut të veçantë në fushën e minierave në Maqedoni.

Reforma

- U rikthye tarifa e lirë e energjisë elektrike, ku u konsultuan të gjithë faktorët relevantë, përfshirë EVN-në dhe Komunitetin Evropian të Energjetikës;
- U aprovua masë e re prej 60 milion denarë, për përkrahje të turizmit vendor për qytetarët me të ardhura të ulëta;
- U nënshkrua Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë të Maqedonisë dhe Bullgarisë, përkatësisht ndërmjet ministrit Kreshnik Beketeshi dhe ministres së Energjetikës të Republikës së Bullgarisë, Temenuzha Petkova;
- Filloi Ndryshimi i Protokollit 2 i Marrëveshjes për tregun e lirë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Turqisë;
- Filloi projektimi i Strategjisë kombëtare për turizëm 2018-2021 në përputhje me Programin për zhvillim të turizmit për vitin 2017.
- Filloi projekti për përkrahje të Delegacionit Evropian për Revizion të politikës industriale dhe përpunimin e politikës së rishikuar industriale;
- Filloi arkëtimi për zëvendësimin e dritareve të vjetra me dritare të reja PVC në amvisëritë për vitin 2017, ku me rebalancimin e buxhetit janë fituar 10 milion shtesë;
- Filloi arkëtimi për avancimin e mbrojtjes së konsumatorëve me harmonizim të mëtutjeshëm të legjislacionit dhe zbatimin efikas të së drejtës në pjesën për mbrojtje të konsumatorëve në kuadër të Programit për mbrojtje të konsumatorëve viti 2017-2018;
- Filloi arkëtimi i kuponëve për pushim vjetor të punëtorëve me të ardhura të ulëta, në përputhje me Programin për ndryshim dhe plotësim të Programit për zhvillim të turizmit për vitin 2017 (pas rebalancimit të buxhetit) të miratuar në vitin 13. 08.2017;
- Filloi arkëtimi për unifikimin e vitrinave të Çarshisë së Vjetër të Shkupit, tashmë 12 dyqane kanë unifikuar vitrinat e punohet për 60 të tjerë.
- Filloi procesi për arkëtimin për subvencionim për Thirrjen publike të projektit nga fusha e turizmit; dhe
- Filloi tërheqja e fituesve për kolektorë solar në kuadër të Programit për kompensimin e harxhimeve për blerjen dhe vendosjen e sistemeve me kolektorë solar.

Ligjet

- Hartimi i Propozim- ligjit të energjetikës;
- Hartimi i Propozim-ndryshimit të Ligjit për heqje të procedurës doganore për regj lëkurë;
- Hartimi i Propozim- ligjit për shërbime të listës së mallrave për gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2017, për të cilët do të shfrytëzohet parimi i shpërndarjes “I pari aplikon- i pari shërbehesh” (I pari shkoni pari fiton);
- Filloi procesi për ndryshim të Ligjit për veprimtari të hotelierisë në pjesën e kategorizimit të objekteve të hotelierisë; dhe
- U bënë gjashtë hapa në drejtim të hartimit të Propozim- ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për automjetet - në procedurë e sipër është mundësia dhe arsyetimi i aprovimit të subvencioneve gjatë blerjes së automjeteve me forcë elektronike elektronik të një pjesë të mjeteve të personave që do të blejnë automjete me forcë elektronike.

Mbi gjashtë evenimente

- Pjesëmarrje në solemnitete me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Akreditimit, me organizim të Institutit për Akreditim të Republikës së Maqedonisë;
- Pjesëmarrje në ceremoninë për ndarjen e certifikatave të kompanive, që kanë zbatuar standardin HALLALL në periudhën nga janari deri në qershor të vitit 2017, ngjarje e cila organizua me patronazh të Agjencisë për Zbatimin e Standardit Hallall në Maqedoni;
- Ndarja e pllakateve 18 minorëve më të suksesshëm dhe mirënjohje për gjashtë shoqata dhe institucioneve për kontributin e veçantë në fushën e minierës në Maqedoni, me rastin e Ditës së Minorëve 28 gusht viti 2017;
- Konferencë për shtyp me rastin e nënshkrimit të Memorandum bashkëpunimit mes dy ministrave, ministrit Kreshnik Bekteshi dhe ministres së energjetikës së Republikës së Bullgarisë, Temenuzha Petkova;
- Prezantimi i masës së re qeveritare prej 60 milion denarë për subvencionimin e turizmit vendor dhe qytetarëve me paga më të ulëta; dhe
- Vizita e Izraelit nga delegacioni qeveritar, prezencë dhe fjalim rasti me biznes forumet në Jerusalemin.

Mbi dhjetë takime me :

- Delegacionin e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore të kryesuar nga kryetari Nebi Hoxha;
- Delegacionin e sipërmarrësve nga Libani të kryesuar nga z. Samer Soufan, kryetar i Këshillit të biznesmenëve nga Libani dhe përfaqësuesve të nëntë kompanive të mëdha libaneze;
- Delegacionin e Komunitetit evropian të energjetikës të kryesuar nga drejtori Janez Kopaç;
- Kryetarin e Shoqatës së Esnafëve “Esanaf” Bejtulla Morina dhe kryesin e kësaj shoqate, e cila funksionon në Çarshinë e Vjetër të Shkupit;
- Ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Çarls Geret
- Ambasadorin e ShBA-së në Republikën në Maqedonisë, Xhes Bejli;
- Ambasadorin e Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë, Fatos Reka;
- Ambasadorin e Republikës së Kosovës në Republikën e Maqedonisë, Ylber Hisa;
- Ambasadorin e Republikës së Hungarisë në Republikën e Maqedonisë Laslo Ishtavan Duks; dhe
- Ambasadorin e Republikës së Francës në Republikën e Maqedonisë, Kristian Timonie;



MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMIZIMIT TË UJËRAVE

(ministër Ljupço Nikolovski)

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave me rebalancin e buxhetit, fitoi buxhet më të madh prej dy milion eurosh. Për të dytën herë pas vitit 2009, bëri filmim me avion të të gjithë territorit të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me legjislacionin dhe rekomandimet evropiane për funksionimin e Sistemit për identifikim të parcelave bujqësore. Ministria pagoi borxh prej 207.000 euro për shërbime konsultative dhe anëtarësim të papaguar në organizatat ndërkombëtare, por arkëtoi edhe dëmshpërblimet nga përmytjet e vjetshme, subvencionet për bujqit, të cilët kultivojnë kultura të ndryshme, blegtorët, peshkatarët, prodhuesit e duhanit, si dhe kapacitetet përpunuese dhe zhvillim të infrastrukturës rurale. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave filloi procedurën për krijimin e zgjidhjeve ligjore për të a.q. nafta e gjelbër e lirë dhe bëri hapat e parë për plotësimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural me qëllim të realizimit të vazhdueshëm të përkrahjes financiare të bujqësisë. Përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomizimit të Ujërave mbi 25 takime me qytetarët, odat ekonomike, të gjithë faktorët e sektorit të bujqësisë si dhe përfaqësuesit e ambasadave dhe institucioneve ndërkombëtare, morën pjesë në 8 evenimente si dhe vizituan shumë rajone bujqësore, sidomos të atyre që periudhën e kaluar kishin probleme me prodhimtarinë ose pësuan nga kushtet klimaterike.

Reforma

- Rritja e buxhetit të Ministrisë për dy milion euro;
- U miratua vendimi nga Qeveria për ndryshime të Programit për financim të drejtpërdrejtë të bujqësisë dhe Programit për zhvillim rural;
- U miratuan 5 udhëzime të reja për efikasitet dhe kontroll më të madh të harxhimit të parave në Ministri;
- U nënshkrua Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë për Tregti të Jashtëme dhe Marrëdhënie Ekonomike të Bosnje Hercegovinës me qëllim të bashkëpunimit rajonal;
- Për herë të dytë pas vitit 2009, u bë filmim me avion i gjithë territorit të Republikës së Maqedonisë në përputhje me rregulloret dhe rekomandimet e funksionimit të Sistemit për identifikim të parcelave bujqësore (SIPBM);
- U nënshkrua Marrëveshje për Projektin e Rajonizimit (zonat agro-ekologjike) të prodhimtarisë bujqësore sipas kushteve klimatike të tokës bujqësore në rajonet e Republikës së Maqedonisë me përkrahje të FAO-s me vlerë prej 355.000 dollarë, me kohëzgjatje prej dy vitesh;
- U pajis Laboratori Fito-sanitar i Shtetit (LFSH) me hromatograf të lëngshëm me kuadripol të trifishtë detektor të masave;
- U formua Komisioni për vlerësim të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, që ndodhën në qershor të vitit 2017, me qëllim bujqit sa më shpejt të dëmshpërblehen;
- U aprovuan masa për arkëtimin e dëmeve të sipërfaqeve bujqësore nga ngrica dhe dëmet nga përmytjet që ndodhën në vitin 2017 edhe atë: Ndhimë për humbjet nga fatkeqësitë natyrore dhe kushtet e pavolitshme klimaterike, që ndodhën në vitin 2017 si dhe ndihmë shtesë për humbjet nga fatkeqësitë natyrore dhe ngjarjeve të pavolitshme;
- U shlye borxh prej 207.000 euro për shërbime konsultative të projektit "Programi për ujitje të luginës Jugore të Vardarit"- faza e dytë, me çka u bë zhblllokimi i projektit;
- U arkëtuan 110 milion denarë ose afro 1,8 milion euro për subvencionimin e bujqve dhe kapaciteteve përpunuese;

- U arkëtuan 354.700.000 denarë subvencione për bujqit për mirëmbajtjen e sipërfaqeve bujqësore me kultura fushore dhe të kopshteve, vreshtave dhe pemëve, material i certifikuar nga farat për të mbjellurat, u shitën kulturat e kopshtarisë në kapacitet përpunuese si dhe infrastrukturës rurale;
- U arkëtuan afro 330 milion denarë për subvencionimin e blegtorisë, bujqësisë, peshkatarisë, prodhimit të duhanit dhe bujkut të ri;
- U arkëtuan 82 milion denarë për subvencionimin e vreshtave dhe pemëve dhe për dëmet e vjetshme (06.08.2016) përmbytjet në Komunën e Gazi Babës;
- U arkëtuan afro 50 milion euro subvencione për bujqësinë;
- U arkëtuan anëtarësimet e pashlyera në organizatat ndërkombëtare, si në Organizatën për Ushqim dhe Bujqësi në OKB (FAO), Organizatën Ndërkombëtare të Verës, Organizatën Evropiane Mesdhetare për Mbrojtje të Bimëve dhe Grupin e përhershëm për zhvillim rural dhe rajonal të Evropës Juglindore (SWG);
- U zhblllokua pagesa për subvencionimet, u arkëtuan 25 milion euro për prodhuesit e duhanit;
- Përfundoi aplikimi i veprimtarisë bujqësore, në të cilën konkurruan mbi 662 persona;
- Morëm ftesë për partneritet për Panairin e 56-të të bujqësisë dhe ushqimit "AGRA" në vitin 2018, që çdo vit mbahet në Gorna Radgona të Sllovenisë;
- U shpallën thirrjet publike për dhënien me koncesion të tokave bujqësore në pronë të shtetit deri më 3 dhe mbi 3 hektarë;
- U zgjidh problemi me stacionin e pompave në disa sisteme të ujitjes (Palurcë, zonën e Tikveshit), me çka u mundësua ujitje pa pengesë e sipërfaqeve bujqësore në këto rajone;
- U soll vendimi për ndihmë financiare plotësuese për prodhuesit e shalqirit;
- U soll vendimi për ndihmë financiare plotësuese për prodhuesit e pjeshkave, dhe
- U vazhdua afati për aplikimin e thirrjes së parë IPARD 2.

Ligjet

- Filloi procedura për krijimin e zgjidhjes ligjore të a.q, naftës së gjelbër të lirë; dhe
- U soll vendim për plotësim të Ligjit të bujqësisë dhe zhvillimit rural me qëllim të realizimit pa pengesë të përkrahjes financiare të bujqësisë.

Tetë evenimente

- Vizita në rajonet bujqësore sidomos të atyre që në periudhën e kaluar kishte problem me prodhimtarinë, por edhe në rajonet të cilat ishin të goditura nga fatkeqësitë natyrore (vizita dhe takime me qytetarët e rrethinës së Tetovës, Poroj, vizita dhe takime me bujqit në Rosoman, vizita dhe takime me bujqit e rajonit të Strumicës, ku kishte problem me blerjen e shalqirit, takime në terren me prodhuesi e mishit të derrit, vizita dhe takime në rajonin e Shkupit, që u godit nga fatkeqësitë natyrore, vizitë në Konjsko, vizitë në pendën Palurci, ku kishte probleme dhe mungesë të ujit për ujitje, vizita në rajonet që u përfshinë nga zjarret);
- Vizitë zyrtare në Izrael;
- Vizitë zyrtarë në Bosnje dhe Hercegovinë;
- Pjesëmarrje në Panairin e ushqimit dhe bujqësisë "AGRA 2017" në Slloveni;
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët për prodhime organike;
- Pjesëmarrje në debate për prodhimtarinë dhe përpunimin e mishit të derrit;
- Pjesëmarrje në punëtorinë për projektin e FAO-s për kooperativa; dhe
- Pjesëmarrje në punëtori për projektin e FAO-s për konsolidim të tokës bujqësore.



Mbi 25 takime me:

- Qytetarët – tregtarët dhe bujqit në Strugë;
- Të gjithë faktorët e sektorit të bujqësisë (prodhuesit e grurit, industrinë e mullirit dhe bukë-pjekjes, prodhuesit e rrushit, kantinat e verës, prodhuesit e mishit të dërrit, kompanitë e industrisë së mishit, shoqatat e bletarëve, përpunuesit e pemëve dhe perimeve, sindikata e AGjShQ, Sindikata e Pavarur e Policisë); Të gjitha odat ekonomike (Oda Ekonomike e Maqedonisë, Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, Oda e Tregtisë);
- Ambasadorët në Republikën e Maqedonisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Holandës, Turqisë, Sllovenisë, Izraelit, Delegacionin e BE-së;
- Ministrat nga Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, në Sarajevë për Rregulloren e Kroacisë për import të pemëve dhe perimeve të freskëta; dhe
- Përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare USAID, Banka Botërore, Banka Gjermane KfW..

MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATËS

(ministër Damjan Mançevski)

Me vendim të Qeverisë, u zbatua orar fleksibël i punës për të gjithë punonjësit në organet e administratës shtetërore dhe afati i fundit për konsultim të Regjistrimit të vetëm elektronik të rregulloreve elektronike zgjatet nga 10 në 20 ditë. Është shpallur thirrje e hapur për komentim të hartimit të Strategjisë për reforma në administratën publike 2017-2022 dhe hartimit të Plan-veprimit, si dhe thirrje për të gjithë palët e interesuara që të dorëzojnë propozime për përpilimin e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audio -vizuale të mediave. Përfaqësues të Ministrisë morën pjesë në dymbëdhjetë evenimente dhe realizuan më shumë se 22 takime me përfaqësues të institucioneve relevante.

Reformat

- Zbatimi i orarit të punës me fleksibilitet për të gjithë punonjësit në organet e administratës shtetërore;
- **Zgjatja e afatit për konsultim të Regjistrimit të vetëm elektronik të rregulloreve elektronike nga 10 deri në 20 ditë;**
- **Thirrje e hapur për dorëzimin e komenteve në lidhje me hartim Strategjinë për RAP dhe Plan-veprimit;**
- **Thirrje për organizatat e shoqërisë civile për të marrë pjesë në nëngrupe tematike për hartimin e Strategjisë për RAP 2017-2022 dhe hartim të Plan veprimit;**
- **Thirrje për të gjitha palët e interesuara që të dorëzojnë propozime për përgatitjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime audio dhe audio - vizuale të mediave; dhe**
- Aprovim për verifikimin e ligjshmërisë së procesit për rekrutim nga dita e shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare deri në ditën e zgjedhjes së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Ligjet

- Propozim-ligji për ndryshimin e Ligjit për punonjësit e administratës.

Dymbëdhjetë evenimente

- Takimi i Komitetit të 14-të për Stabilizim dhe Asociim në Bruksel;
- **Takim konsultativ me të gjithë faktorët për reforma të administratës publike;**
- Forumi i shërbimeve publike të Kombeve të Bashkuara në Hagë;
- Trajnim i parë në kuadër të bashkëpunimit me Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" me qëllim të përmirësimit të njohurive të hetuesve në fusha specifike;
- Trajnim i zbatuar për vlerësimin e ndikimit të rregullores me mbështetjen e ekspertëve norvegjez;
- Konferencë për shtyp kushtuar masave ekonomike për zhvillimin e sektorit të TI;
- **Debat publik me temë: "Reformat në media";**
- Pjesëmarrje në promovimin e investimit të ri të InPlayer;
- Dhënia e kuponëve për pesë studentët më të mirë në bashkëpunim me Huawei;
- Konferencë për shtyp për punësimet e reja në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë



- Konferencë për shtyp për numrin e të punësuarve në sektorin publik;
- Eveniment promovues për projektin “Modernizimi i shërbimeve të inspektimit”;
- **Eveniment promovues „Ndhmë për reforma në administratën publike dhe ngritje të kapaciteteve të MShIA”;** dhe
- Pjesëmarrje në forumin strategjik të Bledit, në Bled, R. e Sllovenisë.

Mbi 22 takime me:

- Përfaqësuesit e Sindikatës së administratës, gjyqësorit dhe shoqatave qytetare (AGjShQ);
- Përfaqësuesit e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë;
- Komitetin për Stabilizim dhe Asociim në Bruksel;
- Kryetarin e Odës për TIK i Lidhjes së Odave Ekonomike, Sasha Oggenovski
- Kryetarinej Sindikatës së punëtorëve në hotelieri, turizëm, strehim dhe shërbime komunale, mjeshtëri dhe shoqëritë mbrojtëse të Maqedonisë, Darko Dimovski;
- Përfaqësuesin e Odës Ekonomike për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit;
- Ambasadorët e shteteve të akredituar në Republikën e Maqedonisë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Francës, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Kroacisë, Izraelit, Mbretërisë së Holandës;
- Përfaqësuesin e ShGM-së dhe përfaqësues të ShMM-së;
- Marko Mantovaneli, drejtor i Bankës Botërore për Maqedoninë dhe Kosovën;
- Ambasadorin e OSBE-s, Nina Soumalinen;
- Sh.S. Luiza Vinton, koordinatorin e përhershme e Kombeve të Bashkuara (OKB) për Maqedoninë dhe përfaqësuesin e përhershme të Programit për zhvillim të OKB-së në Maqedoni;
- Euro -ambasadorin, Samuel Zhbogar;
- Drejtorin e përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit të Shqipërisë, Linda Karcanaj; dhe
- Ministren për Inovacionin dhe Administratën Publike, Milena Harito.

U lidh bashkëpunim

- U nënshkrua Memorandum bashkëpunimi me drejtorin e përgjithshëm të IDEAS DePo, Aleksandër Shahov, për realizimin e aktiviteteve në fushën e punës inspektuese.
- U lidh bashkëpunim për shpërblimin e pesë studentëve më të mirë nga fakultetet e teknologjive e Informacionit dhe komunikimit (TIK).

MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE

(ministre Milla Carovska)

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale realizoi një varg reformash me qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë sociale të qytetarëve dhe të avancojë transparencën dhe funksionalitetin e Ministrisë- aprovoi "Ditë të hapur për qytetarët", aprovoi orar të punës në dy turne në institucionet publike për fëmijë/çerdhet për fëmijë nga ora 07:00 deri 14:30 dhe nga ora 14:00 deri 21:30, si dhe të shtunën e parë të muajit nga ora 08:00 deri 16:00, realizoi më shumë se 300 inspektime gjatë valës së nxehtë të motit, arkëtoi ndihmë financiare të të drejtave për asistencë sociale dhe mbrojtje të fëmijës dhe filloi me arkëtimin mujor të asistencës sociale, kompensimin financiar për ndihmë dhe përkujdesje nga personi tjetër dhe subvencionimin e energjisë elektrike, filloi me shërbimet falas për pushim dhe rekreacion për më shumë se 2000 fëmijë për fëmijët me rrezik social dhe fëmijëve shfrytëzues të shtesës speciale, si dhe bëri ndryshim të Rregullores për verifikimin e të ardhurave të qytetarëve, me çka që të realizohet asistencë sociale, paratë që qytetarët kanë marrë nëpërmjet transferimit të shpejtë, tashmë nuk do t'iu llogariten si të ardhura të familjeve të tyre, sepse në të shumtën e rasteve ato para nuk vijnë nga anëtarët e familjeve të tyre, që kanë obligim ligjor për tu kujdesur. Gjithashtu, Ministria hartoi Propozim - ligj për pagën minimale dhe e dorëzoi në Kuvend, Propozim- ligjin për siguri materiale të papunëve, për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit, propozim që u miratua nga Qeveria, propozoi Ndryshim të Ligjit për mbrojtje sociale, me të cilët për herë të parë aprovohet bazë që Qeveria e Republikës së Maqedonisë të miratojë Program të veçantë për sigurim të asistencës personale. Ndërkaq, filloi edhe me hartimin e Propozim - ligjit për sipërmarrjen sociale. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale realizoi mbi 50 takime me qytetarët, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore të vendit dhe të huaj, sindikatat, organizatat qytetare dhe ambasadat, mori pjesë në më shumë se 19 evenimente, përfshirë vizitat zyrtare, konferencat, debatet publike, prezantimet, seancat, dhe bëri kontroll në objektet e Shkupit, Vrapçishtës dhe Kumanovës të cilat përshtaten në çerdhe për fëmijë.

Reforma

- U aprovua "Ditë e hapur për qytetarët";
- Nga 1 qershori deri më tani, ministrja dhe anëtarët e kabinetit të saj u takuan me 380 qytetarë (në "Ditën e hapur për qytetarët");
- Nga 29 qershor deri më 1 korrik të vitit 2017 gjatë valës së motit të nxehtë ekipet e kujdestarisë të Inspektoratit Kujdestar Shtetëror të Punës, realizuan 97 kontrolle për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë;
- 207 kontrolle inspektimi të punëdhënësve për respektimin e rekomandimit për motin e nxehtë;
- U aprovua kontroll për zbatimin e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve për realizimin e të drejtës për shtesë të fëmijës në Qendrën e punës sociale- Karposh;
- Inspektim të jashtëzakonshëm dhe kontroll të objektit në Rr. "173" nr.8 në Shkup, në bazë të informatave se ekziston objekt me emrin "Bleta", që përkujdeset për fëmijët parashkollor dhe edukon në frymën dhe ritualet fetare;
- U bë arkëtimi i më shumë të drejtave sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve: inavlidor civil, mobilitet dhe verbëri, ndihmë e përhershme sociale, ndihmë e njëhershme financiare, ndihmë financiare për personat që deri në 18 vjeç kanë pasur statusin pa prindër dhe kujdes prindërore, akomodimin në familje që do të përkujdesen, ndihmë financiare për studim, ndihmë financiare për atë që përkujdeset, akomodim social, mbrojtje shëndetësore, shtesë e fëmijës, ndihmë e njëhershme financiare për foshnje, ndihmë shtesë për prindërit të fëmijës së tretë, shtesë për prindërit e fëmijës së katër, shtesë e vetme për prindërit si dhe shtesë e veçantë financiare;
- Filluan arkëtimet e rregullta mujore të asistencës financiare sociale, kompensimin për ndihmë dhe përkujdesje nga person i tretë dhe subvencionimi i energjisë elektrike;



- Filloi rekonstrukcioni për objektin ShF “11 Tetori” i përshtatur si Qendër për fëmijët me paralizë cerebrale;
- Ndryshim të Rregullores për verifikimin e të ardhurave të qytetarëve, me çka që të realizohet asistencë sociale, paratë që qytetarët kanë marr nëpër transferimit të shpejtë, tashmë nuk do t’iu llogariten si të ardhura të familjeve të tyre, sepse në të shumtën e rasteve ato para nuk vijnë nga anëtarët e familjeve të tyre, që kanë obligim ligjor për tu kujdesur;
- Filloi me shërbimet falas për pushim dhe rekreacion për më shumë se 2000 fëmijë për fëmijët me rrezik social dhe fëmijëve shfrytëzues të shtesës speciale nga familjet me rrezik social dhe fëmijë shfrytëzues të shtesës speciale;
- Filloi zbatimin e projektit “Përkrahje për punësim të rinjve” që është pjesë e masave aktive për punësim, të cilat zbatohen me qëllim të përsosjen shkathtësitë e të rinjve të evidentuar, që aktivisht kërkojnë punë në fushën e teknologjisë së informatikës, ku 220 të papunë deri në moshën 29 vjeç do të kalojnë trajnime për “java programues” dhe “softuer testues”, profesione që kërkohen në tregun vendas dhe atë të huaj;
- U formua ekip special që funksionon 24/7, për veprim gjatë rasteve emergjente të kategorive të rrezikuara shfrytëzues të drejtave dhe shërbimeve nga kompetencat e IP Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale të Qytetit të Shkupit;
- Janë miratuar projekte për avancimin e sigurisë sociale dhe standardit jetësor të pensionistëve, duke përfshirë dhënien e obligueshme të dhënies së mbikëqyrjes së stazhit dhe pagave, me të dhëna të verifikuara nga evidenca kryesore amë, për të gjithë punëtorët para se të plotësojnë kushtet e pensionit;
- U nënshkrua Marrëveshja për përkrahje të shoqatave qytetare nga fusha e mbrojtjes sociale, rezultat nga konkurset publike, të cilat u publikuan në ueb-faqen e MPPS-së dhe në RTVM-së nga 18 deri më 21 korrik të vitit 2017. Fondi i përgjithshëm për përkrahje të projekteve është me vlerë pre 2.400.000,00 denarë;
- U bë thirrja publike e personave të interesuar shfrytëzues të asistencës sociale financiare, asistencës së përhershme financiare, shtesës speciale, shtesës të fëmijës, kujdestarit të fëmijëve jetim dhe moskujdes prindëror që të paraqiten për shfrytëzimin e kurseve falas;
- U realizuan trajnime për stafin profesional të MPPS-së, institucionit dhe për stafin profesional të Qendrës të Punës Sociale, organizatave qytetare, punonjësve akademik në temën “Planifikimi personal” për përkrahje të procesit të filluar për deinstitutionalizimit të IP Enti Special Demir Kapi, në kuadër të projektit “Ndihe teknike për përkrahje të procesit të deinstitutionalizimit në sektorin social” me përkrahje financiare të Bashkimit Evropian;
- Në bashkëpunim me Lidhjen Kombëtarë të Personave me Aftësi të Kufizuar Fizike dhe Komunën e Resnjës vendosëm këndin e lojërave të kompletuar me rekuizita ku akses do të kenë fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Aprovuam orar të punës në dy turne në institucionet publike për fëmijë/çerdhet për fëmijë nga ora 07:00 deri 14:30 dhe nga ora 14:00 deri 21:30, si dhe të shtunën e parë të muajit nga ora 08:00 deri 16:00;
- U shpallën thirrje për punësim të stafit profesional të qendrave për punë sociale në vend;
- Filluan përgatitjet për ratifikimin e “Konventës së Stambollit”,
- U hartua Versioni i parë propozues për Strategjinë e re për Integrimin e Refugjatëve dhe të Huajve dhe Propozim për Plan- Veprimin Kombëtar për periudhë 10 vjeçare, përkatësisht për periudhën nga viti 2007 që është dhënë në kontroll publik; dhe
- U nënshkrua dokumenti projektues për rindërtimin e çerdhes “8 Prilli” në Shuto Orizare në kuadër të Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara, dhe përkrahje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Ligjet

- Në Kuvend u dorëzua Propozim - ligji për pagën minimale;
- U miratua Propozim- ligji për siguri materiale të papunëve, për shkak të privatizimit të ndërmarrjeve me pronësi dominuese të shtetit, propozim që u miratua nga Qeveria, me të cilin do të përfshi-

hen të papunët që iu është ndërprerë marrëdhënia e punës në sipërmarrje me pronësi dominuese është shteti pas 1 janarit 1995, dhe në përmbyllje 31 dhjetor viti 2016;

- U propozua Ndryshim i Ligjit për mbrojtje sociale, me të cilët për herë të parë aprovet bazë që Qeveria e Republikës së Maqedonisë të miratojë Program të veçantë për sigurim të asistencës personale; dhe
- Filloi hartimi i Propozim- ligjit për sipërmarrjen sociale.

Mbi 19 evenimente

- Vizitë në Qendrën për Punë Sociale të Kavadarit, njëra nga 30 qendrat në territorin e Republikës së Maqedonisë, që shërbejnë dyqind mijë qytetarë me rrezik social;
- Seanca e 35-të konstituive e Këshillit Ekonomik Social, në të cilën u shqyrtua Raporti për vlerësimin e gjendjes të Këshillit Social dhe Ekonomik në Ballkanin Perëndimor, Propozim- ligj për ndryshim të Ligjit për marrëdhënie pune, si dhe Propozim- Strategjisë për siguri dhe shëndetin gjatë punës 2020;
- Seanca e Këshillit Ekonomik Social për rishqyrtimin e Planit operativ për masat aktive për punësim dhe shërbime të tregut të punës për vitin 2017;
- Konferencë Rajonale për Këshillin Ekonomik Social në Ballkanin Perëndimor (Zëvendësi Aziri);
- Vizitë të fëmijëve nga kategoritë e rrezikuara të cilët pushimet verore i kalojnë në “Majski Cvet” (“Lulja e Majit”) – Strugë;
- Pjesëmarrje në debat publik në temë “Promovim të shërbimeve për inkluzion social”, i cili financohet nëpërmjet Programit për zhvillim të resurseve humane të BE-së;
- Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare të Punës në Gjenevë, e 106-ta me radhë;
- Pjesëmarrje në promovimin e hulumtimit për shfrytëzimin e përparësive sociale dhe faktorëve që kufizojnë aksesin e komunitetit rom “Kompensim financiar për fëmijët me rrezik social”;
- Pjesëmarrje në Konferencën për “Marrëveshjen Globale për migracione dhe Marrëveshjen Globale për refugjatët”;
- Prezantimi i “Propozim-Strategjisë për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës 2020”, me organizim të Ministrisë dhe Punës Socialë, dhe në bashkëpunim me Fondacionin Fridrih Ebert, zyra në Shkup dhe Këshillin e Sigurisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë;
- Fjalimi i rastit për projektin “Integrimi lokal i refugjatëve, personave të zhvendosur brenda vendit dhe grupet pakicë”, i financuar në kuadër të Programit kombëtar për 2011 të komponentit “Ndihmës gjatë tranzicionit dhe përsosjes institucionale”- IPA komponenti;
- Pjesëmarrje në Seancën konstituive në Këshillin për ndjekjen e gjendjes së sistemit pensional;
- Pjesëmarrje në konferencën përmblylëse të IPA projektit “Partneritetet lokale për inkluzion social”, i implementuar nga Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) në partneritet me CNVOS nga Sllovenia dhe Qendra për Nismë Qytetare nga Prilepi;
- Pjesëmarrje në eveniment që u mbajt në OPÇF “11 Tetori”- Çair, në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja “Avancimi për shërbime alternative për përkujdesin e fëmijëve”;
- Pjesëmarrje në debatin për Garanci të të rinjve si njëra nga masat me prioritet të Qeverisë;
- U bë kontroll i objektit në Rr. “Orce Nikollov”, ku është lokalizuar Qendra e re ditore për fëmijët me sindromën Daun, në objektin ku prej në shtator filloi çerdhja e parë në Komunën e Vrapçishtës, si dhe objekti i ish Shtëpisë së Pionierëve në Kumanovë, në të cilin aktualisht bëhen rekonstrukcione dhe përshtatet si çerdhe për fëmijë..

Mbi 50 takime me

- Numër jashtëzakonisht të madh të qytetarëve në kuadër të “Ditës së hapur për qytetarët”;
- Minatorët nga Makedonska Kamenica;
- Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetit dhe Qendrës Klinike në Shkup;



- Kryetarin e Komunës së Haraçinës (Zëvendësministri Aziri);
- Kryeartin e Komunës së Likovës, Bashkim Amidi (Zëvendësministri Aziri);
- Ministrin e shëndetësisë dr. Arben Taravari, ministrin pa resor, z. Samka Irbaimovski, kryetarin e Shoqatës së Gjinekologëve të RM-së, dr. Dushko Filipovski dhe përfaqësuesit të organizatave jo-qeveritare;
- Përfaqësues të SPASHK për punën me dy turne të Objekteve publike për fëmijë/ çerdheve për fëmijë;
- Përfaqësuesit e Konfederatës së Sindikatave të Maqedonisë;
- Anëtarët e Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve në Media;
- Sindikatat lidhur me rritjen e pagës minimale;
- Punëdhënësit, punëtorët dhe përfaqësuesit e shoqatave qytetare nga Shtipi, së bashku me kryeministrin;
- Përfaqësuesit e koalicionit për mundësimin e dhurimit të ushqimit të tepërt “Hajde Maqedoni”, “Platforma e Maqedonisë kundër varfërisë”, “Retvitni obrok dhe Vepra reale të mirësjelljes”, përfaqësuesin e Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari dhe drejtorin e Institutit Nacional Demokratik Kris Henshou, së bashku me ministrin e financave Dragan Tevdovski dhe ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Ljupço Nikolovski;
- Përfaqësuesit dhe bashkëpunëtorët e Organizatës Rome për Afirmim Multikulturor (Roma SOS);
- Përfaqësuesit e Nismës Qytetare “5 më 12”;
- Përfaqësuesit e projektit “Smart start”;
- Përfaqësuesit e UNICEF-it për Maqedoninë (Zëvendësministri Aziri);
- Përfaqësuesen e Rrjetit Kombëtar në luftën kundër dhunës së grave dhe Platformën për barazi gjinore;
- Përfaqësuesit e UN agjencive të udhëhequra nga koordinatorja e përgjithshme e OKB-së dhe përfaqësuese së përhershme të UNDP-së në Republikën e Maqedonisë Luiza Vinton;
- Shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, ambasadorin Samuel Zhbogar;
- Ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ambasadoren e Konfederatës së Zvicrës, Sibil Suter, Tejada;
- Ambasadorin e ShBA-së në Republikën në Maqedonisë, Xhes Bejli;
- Takim me Komitetin e përbashkët drejtues në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit me OKB-në; dhe
- Grupin e punës për përcaktimin e Plan veprimit për masat urgjente për avancimin e gjendjes në Shtëpinë Speciale Demir Kapi.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

(ministre Reneta Deskoska)

Ministria e Arsimit dhe Shkencës abrogoi testimin ekstern për arsimin fillor dhe të mesëm, prolongoi aprovimin e Programit “Kembrixh” në shkollat e mesme, për shkak të përgatitjes dhe realizimit më cilësor të programit. Bëhet fjalë për revizion të të gjithë librave shkollorë të të gjithë niveleve të arsimit nëpërmjet debateve në nivel ekspertësh, në kuadër të MASH-it dhe sistem- pyetësorit për hulumtimin e mendimit për arsimtarë dhe profesorë për librat shkollorë. Me rebalancin e buxhetit u siguruan 45 milionë denarë shtesë për standardin e nxënësve dhe studentëve, por edhe hartohet Strategji për zhvillimin e arsimit 2017-2022, përkrahur nga Programi IPA. Ministria filloi proces të zgjeruar konsultativ në kuadër të gjitha proceseve reformuese, të cilët janë në kompetencat e resorit, me çka u konsultuan dhe u inkuadruan të gjitha palët e përfshira. Gjithashtu u realizuan takime të shumta me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, të cilët punojnë fushën e arsimit.

Reforma

- Në proces është revizioni i të gjithë librave shkollorë të të gjithë niveleve;
- Në fazën e dytë të procesit të revizionit, do të filloi procesi konsultativ për përzgjedhjen e duhur të lektyrave për arsimin fillorë dhe të mesëm;
- Heqja e ngarkesës administrative teknike e arsimtarëve - MASH harton ndryshim të akteve nën-ligjore për të zvogëluar ngarkesën administrative të mësimdhënësve, që paraqet ngarkesë plotësuese dhe ndikon në cilësinë e arsimit;
- “Paralele EVN” ose projekt “20-20-20” në kuadër të së cilës është hartuar program mësimor nga ekipet e shkollës profesionale “Mihajlo Pupin” me ekspertë të EVN-së dhe MASH-it- projekt nëpërmjet të cilit në vitin 2020 do të punësohen 230 nxënës në EVN dhe do të fitojnë nga 20 mijë denarë në muaj;
- “Fuqizimi i arsimit gjatë gjithë jetës nëpërmjet modernizimit të sistemit për arsim profesional” dhe trajnim dhe arsim për të rritur”- janë miratuar programe të reja arsimore me lëndë profesionale dhe mësim praktik për vitin shkollor 2017/2018, të hartuara nga projekti i Këshillit Britanik;
- Realizimi i trajnimeve profesionale në shtëpitë e ndëshkimit dhe korigjimit me Drejtorinë për ekzekutimin e sanksioneve dhe Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP)- trajnimet realizohen me qëllim risocializimin më të shpejtë të personave të dënuar dhe përfshirjes së tyre më të lehtë në tregun e punës pas daljes nga burgu, si dhe avancimin e inkluzionit social të kategorive më të rrezikuara të shoqërisë;
- U miratuan 35 programe të reja mësimore dhe programe trevjeçare për aftësimin profesional të vitit të parë me dizajn modular;
- U miratuan 13 programe të reja mësimore dhe programe dyvjeçare për aftësimin profesional të vitit të parë me dizajn modular;
- U miratuan programe të reja mësimore me dizajn modular për arsimin profesional për vitin e parë për kualifikimet teknike dhe të ndërtimit, teknik- elektrik për teknikën dhe automatikën kompjuterike, dhe për teknik hotelierik- turistik i hartuar nga Qendra për Arsim dhe Trajnime në kuadër të projektit për zhvillim të shkathtësive dhe përkrahje të inovacionit (Skills Projekt);
- U aprovua formimi për paralele me pak nxënës, me kërkesë të një numri të madh të komunave në përputhje me Ligjin për arsim fillor dhe të mesëm;
- U ndryshuan dy rregullore që rregullojnë çështje të caktuara në fushën e arsimit të fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet procesit të konsultimit me shoqatat e qytetarëve që merren me çështjen e inkluzionit në arsim;



- U propozua ndryshim të Vendimit për bllok dotacionet për transportin e nxënësve të shkollave të mesme me nevoja të veçanta arsimore;
- Në fazë të përgatitjes është edhe formimi i grupit të punës për avancimin e të drejtave dhe mundësive të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore;
- U formua grup i punës me organizatat qytetare me të cilat punohet në Propozim- ndryshimin e Ligjit për arsim të mesëm, me qëllim të riformimit të sistemit pjesëmarrje e nxënësit;
- Rebalancim i buxhetit me të cilin u parapanë 35 milion denarë shtesë për standardin e studentëve dhe 10 milion denarë për bursat e nxënësve dhe shkollimi; dhe
- Hartimi i Strategjisë për zhvillim i arsimit 2017-2021, përkrahur nga Programi IPA.

Evenimente

- “Fabrika e diturisë” në organizim të Universitet të parë privat – FON”;
- Ndarja e diplomave dhe shpërblimeve për 10 studentët më të mirë të FShIK;
- Vizita e Komunës së Tetovës dhe takim me profesorët dhe prindërit e nxënësve që mësimin e zhvillojnë në gjuhën maqedonase ShMKGj “Kiril Pejçinoviç”;
- Vizita e ShF “Vëllezërit Milladovci” dhe ShMK “Pero Nakov” në Kumanovë me rastin e fillimit të vitit shkollor; dhe
- Promovimi i 120 librave të shtypur me alfabetin e Brajnit në Shkollën Shtetërore për Fëmijë dhe të Rinj me Shikim të Dëmtuar “Dimitar Vllahov” në Shkup.

Ligjet

- Ligji për ndryshim të Ligjit për arsim fillor, Ligji për arsimin fillor, Ligji për ndryshim të Ligjit për arsim të mesëm dhe Ligjin për ndryshim të Ligjit të arsimtarëve në shkollat fillore dhe të mesme, me qëllim heqjen e testimit ekstern;
- Hartim Propozim – ligjit të Ligjit për arsimin e lartë, nëpërmjet grupeve inkluzive të punës, ku janë përfshirë të gjitha palët e përfshira;
- Hartimi i Propozim- ndryshimit të Ligjit për arsim të mesëm me qëllim të riformimit të sistemit për pjesëmarrje të nxënësit nëpërmjet grupeve të punës me përfaqësues të organizatave relevante qytetare; dhe
- Në proces është formimi i grupit të punës për ndryshim të Ligjit për arsimin fillor dhe Ligjin për arsim të mesëm..

Takime me:

- Drejtorin e Grupacionit të Bankës Botërore për Maqedoninë, Marko Mantovaneli;
- Nismën Qytetare “5 më 12”- përfshirë edhe nismën e cila përfaqëson interesat e personave me aftësi të kufizuara në grupet e punës për ndryshim të Ligjit për arsimin fillor dhe të mesëm, Ligjin për librat shkollorë dhe Strategjinë e Arsimit 2017-2021, duke plotësuar obligimet për arsim inkluziv;
- Përfaqësuesit e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodij”- Shkup, Universitetit Shtetëror të Tetovës, Universitetit “Kolegji Amerikan”- Shkup, Universitetit “Goce Dellçev”- Shtip, Universitetit “Shën Kliment Ohridski”- Manastir, Universitetit të Evropës Juglindore, Universitetin e Parë Privat – FON Shkup, “Plenumin Studentor”, “Plenumin e Profesorëve”, SPAK, SPASHK në kuadër të grupit të punës për konstatimin e nevojës së punës për ndryshim të Ligjit për arsim të lartë;
- Drejtorin e përgjithshëm të EVN-Maqedoni, Petar Shtefan, ku u diskutuan nevojat të projektit “20-20-20” ose “Paralelen EVN” në shkollën e mesme të elektroteknikës “Mihajlo Pupin”;
- Ministren e Shkencës të Malit të Zi, Sanja Damjanoviç, ku u dha përkrahje për nismën Institutit Ndërkombëtar për Teknologji të Qëndrueshme të Ballkanit me misionin “Shkencë për paqe”, e cila ka për qëllim të promovojë bashkëpunimin mes shkencës, teknologjisë dhe industrisë së Ball-

kanit, përkatësisht të jetë platformë për edukimin e të talentuarve, të rinjve dhe inxhinierëve në bazë të transferimit të njohurive dhe teknologjive të qendrave evropiane dhe laboratorëve;

- Përfaqësuesin e ri të UNICEF-it në Maqedoni z. Benxhamin Perks me qëllim të vazhimit dhe thellimit të bashkëpunimit me UNICEF-in;
- Delegacionin e ekonomisë Gjermanisë në Maqedoni, i përbërë nga Shefi i delegacionit të Maqedonisë, z. Patrik Martens dhe koordinatorin e projektit për arsim të mesëm profesional dual, z. Tobias Bole ku u bisedua për nevojat e reformave të arsimit të mesëm;
- Drejtorin e USAID-it, z. Dejvid Ateberi;
- Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, FRM (MOF), "TANI" (SEGA), FShAM (FOOM), "Megjashi", QMAQ (MCGO), "Hap pas hapi" dhe OJQ të tjera si pjesë e punës së tyre që trajtojnë tema të fushës së arsimit; dhe
- Numër të madh të ambasadorëve të më shumë shteteve me qëllim të avancimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, avancimin e mobilitetit të hulumtuesve dhe studentëve, thellimin dhe pasurimin e bashkëpunimit bilateral.

Bashkëpunimet e ndërmarra

- U nënshkrua Memorandum bashkëpunimi me KNRM-në Këshillin Nacional Rinor të Maqedonisë;
- U nënshkrua Protokoll nga mbledhja e pestë në Komisionin e përbashkët për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik, ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Popullore të Kinës, me të cilin u miratuan 13 projekte maqedonaso - kinez në fushën e hulumtimit dhe shkencës..

Tjetër

- U miratua vendimi për punësime në shkollat fillore dhe të mesme me kohë të caktuar të punës në bazë të financimit të shkollave të reja, paralele të reja, u rrit numri i nxënësve në klasë të parë, kërkesë të prindërve për vazhdim të qëndrimit ditor dhe mësimin gjatë gjithë ditës;
- U miratuan punësime të kuadrit arsimor në universitete;
- U tërhoq nga përdorimi i librit shkollor i lëndës së "Shoqërisë" për klasën e IV, për arsimin fillor nëntëvjeçar;
- U tërhoq nga përdorimi libri shkollor nga lënda "Edukimi qytetar" për klasën e VIII, për arsimin fillor nëntëvjeçar;
- Projekt për vlerësimin e arsimit – UNICEF, MASH përkrahu analizën e sistemit të evalvimit dhe vlerësimin të arsimit në Republikën e Maqedonisë;
- U miratuan vendime për aprovimin e programit të ri studimor dhe aprovim për regjistrim të studentëve në institucionet e arsimit të lartë të programeve të reja studimore ose programe studimore që nuk ishin në funksion



MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE

(ministër Suhejl Fazliu)

Ministria e Vetëqeverisjes Lokale filloi realizimin e projektit “Konsolidimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale” në bashkëpunim me UNDP dhe përkrahjen financiare prej 2,3 milion eurosh nga Bashkimi Evropian me qëllim të avancimit të shërbimeve publike lokale dhe siguroi qasje të barabartë për të gjithë qytetarët. Filloi edhe procesi konsultativ për stimulimin e zhvillimit lokal dhe zvogëlimin e dallimeve rajonale për avancimin e sistemit të financimit të shpërndarjes së përgjithshme me transparencë dhe në mënyrë të drejtë të bllok-dotacioneve kapitale, por edhe gjetjen e mënyrës së duhur për jetësimin e bashkësive lokale dhe vendosjen në funksion të potencialit të pashfrytëzuar për përmirësimin e shërbimeve që nxisin zhvillimin lokal. U hartua analizë për përcaktimin e veprimtarive me kuptim më të gjerë dhe interes, për të cilat mund të ndahen mjete financiare për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal gjatë periudhës të vitit 2018-2020, janë bërë edhe konsultime me ministritë përkatëse për stimulimin e përkrahjes të bashkëpunimit ndërkomunal. U publikua shpallja e parë publike bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës me vlerë të përgjithshme prej 2 milion e 40 mijë euro nga Bashkimi Evropian për projektin e dy shteteve, kurse në përdorim është lëshuar edhe rruga lokale deri në Liqenin e Likovës me gjatësi 1720 metra. Përfaqësuesit e Ministrisë morën pjesë në katër evenimente dhe realizuan tetë takime me përfaqësuesit e institucioneve relevante dhe ambasadorët e akredituar në Republikën e Maqedonisë.

Reforma

- Filloi procesi i konsultimit për stimulim të zhvillimit lokal dhe zvogëlimin të dallimeve rajonale nëpërmjet rishqyrtimit të sasisë së mjeteve dhe mekanizmave për shpërndarjen e tyre.
- Filloi realizimi i projektit: “Konsolidimi i sistemit të vetëqeverisjes lokale” në bashkëpunim me UNDP dhe përkrahjen financiare prej 2,3 milion eurosh nga Bashkimi Evropian;
- Filloi procesi i konsultimit me të gjitha palët e përfshira, (me këto ministri: e Financave, Arsimit, Punës dhe Politikës Sociale, Kulturës si dhe BNjVL-së) për avancimin e sistemit të financimit të shpërndarjes së përgjithshme me transparencë dhe në mënyrë të drejtë të bllok-dotacioneve kapitale;
- Filloi procesi i konsultimit me të gjithë përfaqësuesit të bashkësive urbane dhe ato lokale, komunitat dhe ekspertët për gjetjen e mënyrës së duhur për jetësimin e bashkësive lokale dhe vendosjen në funksion të potencialit të pashfrytëzuar për përmirësimin e shërbimeve që nxisin zhvillimin lokal;
- Filloi skenimi i kapaciteteve të komunave dhe hartimi i modelit të duhur të qendrës komunale të shërbimeve për sigurim të shpejtë, cilësor dhe me kosto të ulët të shërbimeve administrative;
- Hartimi i analizës për përcaktimin e veprimtarive me rëndësi më të gjerë dhe në interes për të cilat do të mund të ndahen mjete financiare për stimulimin e bashkëpunimit ndërkomunal në periudhën e vitit 2018-2020 (mbrojtja e mjedisit jetësor, mbrojtje sociale dhe kujdes për fëmijët, zhvillim lokal ekonomi, veprimtari komunale; mbrojtje nga zjarret);
- U realizuan konsultime me ministritë përkatëse dhe u dakorduan aktivitetet për bashkëpunim në nxitjen e përkrahjes të bashkëpunimit ndërkomunal, për shkak të sigurimit më efikas, më ekonomik dhe më cilësor të shërbimeve;
- U publikua shpallja e parë publike bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës me vlerë të përgjithshme prej 2 milion e 40 mijë euro nga Bashkimi Evropian për projektin e dy shteteve. Koфинacim me vlerë prej 15% nga mjetet e shfrytëzuara i siguron Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Mjetet janë destinuar për projekte në dy fusha: konkurrim dhe zhvillim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me vlerë prej 1 milion euro dhe milionin e dytë për projekte të stimulimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Shfrytëzuesit potencial janë komunat, qendrat për zhvillim të rajoneve malore, organizatat joqeveritare, universitet,

shkollat, asociacionet e biznesit dhe subjekte të tjera jofitimprurëse nga Rajoni i Pollogut, Shkupit dhe Rajonit Verilindor malor; dhe

- U lëshua në përdorim rruga lokale e riparuar nga Liqeni i Likovës me gjatësi prej 720 metrash, e financuar nëpërmjet projektit të Komunës së Likovës të Programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë.

Katër evenimente

- Pjesëmarrje në Konferencë me shefin e Delegacionit të BE-së dhe përfaqësuesen e përhershme të UNDP-s u promovua projekti për konsolidim i sistemit të vetëqeverisjes lokale, avancimi i shërbimeve komunale dhe sigurimi i qasjes të barabartë për të gjithë qytetarët;
- U mbajt forumi me temë “Bashkësia lokale vetëqeverisëse potencial i pashfrytëzuar për përforcimin e bashkësive lokale” me çka Ministria e Vetëqeverisjes Lokale hapi debat për statusin e bashkësisë lokale vetëqeverisëse në sistemin e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë;
- Pjesëmarrje në Forumin për avancimin e shërbimeve të personave me aftësi të kufizuara; dhe
- Vizitë në Rajonin Juglindor dhe Verilindor.

Më shumë se tetë takime me:

- Kryesinë e Sindikatës së Pavarur të Zjarrfikësve të Maqedonisë (SPZM), për shkak të zgjidhjes të problemeve lidhur me mënyrën e formimit të financimit të shërbimit të tyre, tendencës për zvogëlimin e numrit të zjarrfikësve të vendit, nevojës për ndryshime ligjore të Ligjit për zjarrfikësit, si dhe pajisjet e vjetra dhe të pamjaftueshme e pjesëtarëve të njësive të zjarrfikësve;
- Kryesinë e Qendrës për Zhvillim të Rajoneve Malore, për shkak të zgjidhjes së problemeve financiare të punës të Qendrës, si dhe implementimin e projekteve që vijnë;
- Delegacionin nga Ministria e Administratës dhe Zhvillimit Territorial të Ermenisë;
- Përfaqësuesen e përhershme të UNDP, Luiza Vinton;
- Drejtorin e Korpusit të Paqes të ShBA-s në Republikën e Maqedonisë, Mark Hanfin;
- Shefin e Delegacionit të BE-së, ambasadorin Samuel Zhbogar;
- Ambasadoren e Zvicrës, Sibel Suter Tejada;
- Ambasadorin e Republikës së Italisë, Karlo Romeo; dhe
- Ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie.

MINISTRIA E KULTURËS

(ministër Robert Allagjozovski)

Ministria e Kulturës formoi dy grupe të punës për hartimin Propozim- Strategjisë kombëtare për zhvillimin të kulturës gjatë periudhës 2018-2022 dhe për hartimin e Analizës për realizimin dhe pasojat e a.sh. "Projekti Shkupi 2014". Filloi realizimi i programeve të miratuara të institucioneve kombëtare dhe projekteve të shfrytëzuesve të tjerë të mjeteve të buxhetit nga të gjitha fushat dhe veprimtaritë e kulturës, si dhe të manifestimit "Vala e re kulturore" në vitin 2017, për të cilën deri më tani janë ndarë 6 milion denarë për 56 aplikime. Filloi edhe procesi i konstatimit të gjendjes së borxhit të Ministrisë gjatë periudhës 1/6 2017, kurse është bërë edhe intervenim për sanimin e dëmeve dhe rreziku nga shirat e rrëmbyeshëm të qytetit në qershor të vitit 2017 si dhe dislokimi dhe mbrojtja e kryeveprave të çmuara nga Galeria e Ikonave. U hartuan më shumë propozim ligje për ndryshim dhe plotësim të ligjeve, ndër të cilat Ligji për përdorimin e gjuhës maqedonase, Ligji i kulturës, Ligji për veprimtari të filmit, Ligji për mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe Ligjit për të drejtë autoriale dhe të drejtat e ndërlidhura. Përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës hapën dhe morën pjesë në 10 takime dhe realizuan mbi 20 takime me ambasadorët e akredituar në Republikën e Maqedonisë.

Reforma

- U formua grup i punës për përpunimin e Propozim- Strategjisë kombëtare për zhvillimin të kulturës gjatë periudhës 2018-2022, në përbërje: Zlatko Teodosievski, kritik letrar dhe këshilltar- kurator (koordinator i grupit të punës); Iskra Geshoska, punonjëse e kulturës nga "Jadro"- Asociacioni për Skenën e Pavarur Kulturore; d-r Valentina Poceska -këshilltare - konservatore, mr. Valmira Istrefi- studime urbane, mr. Xhevdet Jashari, aktor dhe ligjërues në Fakultetin e Shkencave të Dramës në Universitetin Shtetëror të Tetovës; Magdalena Dikovska, punonjëse e kabinetit për çështje juridike në Ministrinë e Kulturës; dhe Goce Bozhovski, këshilltar në Sektorin për artin vizual, arkitekturë dhe dizajnë në Ministrinë e Kulturës;
- U formua grupi i punës për hartim të Analizës për realizimin e pasojave të a.q. "Projekti Shkupi 2014", në përbërje: prof. Dr. Miroslav Grçev, profesor i rregullt në Fakultetin e Arkitekturës në UKIM (koordinator), mr. Nikola Naumoski, politikolog dhe komunikolog, Martin Panovski, inxhinier i diplomuar-arkitekt, doc. dr. Donka Barxhieva- Trajkovska, historiane e artit dhe konservatore dhe Zlatko Teodosievski, kritik artit të pikturës dhe këshilltar- kurator;
- Filloi realizimi i programeve të miratuara të institucioneve kombëtare dhe projekteve të shfrytëzuesve të tjerë të mjeteve të buxhetit nga të gjitha fushat dhe veprimtaritë kulturore 27 projekte nga fusha e dramës; 136 koncerte muzikore dhe performime të baletit; 10 projekte të artit të pikturës dhe 25 manifestime folklorike, koncerte dhe manifestime.
- Me qëllim të sigurohet demetropolizimi, dekoncentrimi i kulturës në qytetin e kulturës, ajo të disperzohet në rrethet lokale, të pasurohet, të zgjerohet, intensivkohet, të ketë dinamik më të madhe të ofertës kulturore. Ministria e Kulturës nëpërmjet Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe përkrahje të partnerëve të tjerë potencial, sponsorëve dhe donatorëve, filloi me realizimin e manifestimit "Vale e re kulturore" në vitin 2017, dhe deri më tani shpërndau afro 6 milion denarë për 56 aplikime;
- Filloi procesi i nënshkrimit të Memorandumit për mirëkuptim mes Ministrisë së Kulturës dhe RP të Kinës dhe vendeve të EQL dhe mori përkrahje për idenë e Qendrës për Bashkëpunim Kulturor mes vendeve të Evropës Juglindore dhe Republikës Popullore të Kinës në kuadër të nismës "15+1", të vendoset në Shkup;
- U nënshkrua marrëveshje për bashkëpunim kulturor me Bosnje dhe Hercegovinën, si dhe me Republikën e Bullgarisë;
- Filloi procesi për kontrollin e gjendjes së borxhit të Ministrisë së Kulturës për periudhën 1/6/2017, me çka Qeveria e Republikës së Maqedonisë erdhi në përfundim se urgjent Enti Shtetërorë për Revizion, në përputhje me kompetencat ligjore, në programin e saj për punë të përfshijë edhe revizionin e Ministrisë së kulturës, sidomos për atë se për punën financiare të Ministrisë së Kulturës, revizion nuk është bërë që në vitin 2011;
- Intervenim për sanimin e dëmeve dhe rrezikun e mëtejshëm pas shirave të rrëmbyeshëm dhe breshrit që ra në Shkup, në qershor të vitit 2017 në Çifte Hamam, Hamami i Daut Pashës, Muzeun e Maqedonisë;

- U bë dislokimi dhe mbrojtja e veprave të çmuara nga Galeria e Ikonave; dhe
- Filloi procedura për revizionin, kontrollin e të gjitha aktiviteteve të kishës “Shën Gjorgji” në Kurbinovë dhe kompleksin e manastirit Treskavec..

Ligjet

- Propozim -ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për gjuhën maqedonase, që tashmë është në procedurë kuvendare, me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të gjuhës maqedonase në komunikimin publik, përkundër anashkalimit dhe moskujdesin për gjuhën maqedonase në më shumë aspekte;
- Propozim- ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kulturë, i cili tashmë është procedurë kuvendare me qëllim të rikthimit të parimit të barazisë për të gjithë artistët dhe bashkëpunëtorët profesionistë nga fusha e kulturës të cilët kanë fituar shpërblime shtetërore nga fusha e kulturës, me çka krijohen kushte të barabarta për realizimin e të drejtave në fushën e krijimtarisë;
- Propozim- ligj për ndërprerjen e Ligjit për artistin kombëtar të Republikës së Maqedonisë, që tashmë është në procedurë kuvendare, me qëllim që në të ardhmen të pamundësohet trajtimi i pabarabartë ndërmjet artistëve dhe të punësuarve të tjerë të kulturës, të cilët kanë të ardhura më të ulëta se paga mesatare e arkëtuar në Republikën e Maqedonisë, lidhur me artistët kombëtar, të cilët në mënyrë aktive akoma punojnë dhe sigurojnë mjete për ekzistencë;
- Propozim- ligji për ndryshim të Ligjit për kulturë, i cili tashmë është procedurë kuvendare me qëllim të zvogëlimit të obligimeve financiare në bazë të pagesës së kompensimit të pensionistëve, të cilët janë fitues të çmimeve shtetërore të kulturës;
- Propozim- ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për kulturë, i cili tashmë është në fazë të përgatitjes;
- Propozim- ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për veprimtari filmike i cili është në fazë të përgatitjes.
- Propozim- ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, i cili është në fazë të përgatitjes; dhe
- Propozim- ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për të drejtën autoriale dhe të drejtat e ndërlidhura, i cili është në fazë të përgatitjes.

Mbi dhjetë evenimente:

- Pjesëmarrje në hapjen e më shumë aktiviteteve kulturore, manifestimeve, festivaleve, shënimin e datave të rëndësishme në të cilat demonstron angazhimet për respektimin e diversitetit kulturor, barazi dhe qasje ndaj kulturës për të gjithë qytetarët, përfshirë këtu edhe pjesëmarrje në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve dhe shënimin dhe shënimin dhe shënimin e Ditës së Holokaustit ndaj romëve. Për herë të parë në histori ngjarjet historike në vend, ministër i kulturës hapi fundjavën “Skopje Pride Weekend 2017”;
- U organizua debati i parë publik për të gjitha palët e përfshira, me çka filluam procesin e rishqyrtimit të legjislacionit dhe praktikës së avancimit të zgjidhjes të çështjes të së drejtave autoriale dhe të drejtave të ndërlidhur dhe menaxhimi i tyre kolektiv;
- Pjesëmarrje në debatin publik “Rokenrolli si sauntrak i ri Ministrisë së Kulturës të RM-së” në organizim të nismës për asociacionin joformal muzikantë të rokut, 1 qershor 2017;
- Pjesëmarrje në debatin publik “Investim në kulturë art dhe mundësi për demaskim”, FPM (Akto Festival) dhe përkrahje nga Fondacioni Fridrih Ebert;
- Pjesëmarrje në diskutim publik, “Si të arrijmë te publiku më cilësor” në Manastir me organizim të QKR Manastir;
- Pjesëmarrje në debatin publik “Çfarë duhet të bëhet me Shkupin 2014?”, me organizim të “Sheshit Liria” (Ploshtad Sloboda), me përkrahjen të Fondacionit “Hajnrih Bel”.

Mbi 20 takime me:

- Ambasadorët në Maqedoni me qëllim të përcaktimit të modeleve dhe mundësive konkrete të bashkëpunimit kulturor bilateral dhe multilateral.



MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

(ministër Sadulla Duraku)

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor ndërmori aktivitete për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike, me Propozim -ligj për ratifikimin të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Me kryetarin e komunës së Kumanovës, i cili njëkohësisht është edhe kryetar i Rajonit malor Verilindor, Zoran Damjanovskin, ministri nënshkroi Memorandumin për implementimin e Marrëveshjes Kornizë mes Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Komuniteteve evropiane për procedurat për implementimin e ndihmës financiare nga Unioni. Me nënshkrimin e këtij dokumenti u vendos themel bazë për suksesin e implementimit të pesë projekteve të planifikuara në kuadër të Programit disaveçar operativ sektorial për mjedisin jetësor dhe aksioneve klimatike IPA II (2014-2020). U formua Komisioni për zgjidhjen e problemeve me deponinë në Strugë dhe filloi me aktivitete intensive për vendosjen e sistemit rajonal të integruar për menaxhimin me mbeturinat në Rajonin malor Jugperëndimor. U hartua Raporti i gjashtë kombëtar i Konventës për diversitet biologjik, me mbështetje të GEF/ UNEP. Gjithashtu u publikua edhe Raporti për cilësinë e mjedisit jetësor, në përputhje me Ligjin për mjedis jetësor. U lidhën më shumë se 17 Marrëveshje, lidhur me projektet nga fusha e mjedisit jetësor, kurse përfaqësues të ministrisë morën pjesë në më shumë se tetë evenimente dhe realizuan më shumë se dhjetë takimi.

Reforma

- Formimi i Komisionit për zgjidhje të problemeve me deponinë e Strugës?
- Aktivitete intensive për vendosjen e sistemit rajonal të integruar për menaxhimin me mbeturinat në Rajonin Jugperëndimor;
- Hartimi i Raportit të gjashtë kombëtar i Konventës për diversitet biologjik, me mbështetje të GEF/ UNEP;
- U publikua Raporti vjetor për cilësinë e mjedisit jetësor të RM-së, në përputhje me Ligjin për mjedis jetësor;
- U bë publikimi i furnizimeve publike dhe ndërtimi i fazës së dytë nga sistemit të kolektorit për Komunën e Koçanit;
- Filloi ndërtimi i stacionit të pastrimit në Koçan;
- U bë shpallja publike nga Komuna e Strugës për operator, i cili do të kujdeset për deponinë e Strugës dhe do menaxhojë në mënyrën e duhur, deri në mbylljen përfundimtare të saj, në përputhje me dispozitat ligjore;
- Procesi vijues për fitimin e miratimit të nënshkrimit të marrëveshjes bilaterale për ndihmë financiare për projektin për furnizim me ujë dhe trajtim të ujërave të zeza në Dellçevë;
- U bë shpallja e furnizimeve publike për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Hotël, Komuna e Kumanovës;
- U bë shpallja e furnizimeve publike për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Veleshtë, Komuna e Strugës;
- U bë shpallja e furnizimeve publike për ndërtimin gypave të ujësjellësit në fshatin Nikushtak, Komuna e Likovës;

Ligjet

- Ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike, me Propozim –ligj për ratifikimin të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë;
- U miratua Rregullorja për ndryshim të rregullore për eksportimin, importimin dhe trazimtimin e mbeturinave; dhe
- U miratua Rregullorja për mënyrën e përcaktimit dhe mirëmbajtjes të rrugicave malore.

Mbi nëntë evenimente

- Promovimi i simbolit memorial të vendosur në rrugicën historike Pano në Pelister, i dedikuar Luftës së parë botërore;
- U vendos gurëthemeli i stacionit të pastrimit për ujërat e zeza në afërsi të fshatit Mojance;
- U bë ceremonia celebruese për shënimin e fillimit të projektit për rregullimin e shtratit të Lumit të Likovës në Kumanovë;
- Promovimi i projektit për Mbrojtje të natyrës, me vlerë prej 4,3 milion euro, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Programi për zhvillimi i Kombeve të Bashkuara;
- U realizua vizita e ministrit Duraku, ministrit Shapuriq dhe ministrit Merko në deponinë e egër të Komunës së Strugës, dhe shqyrtimin zgjidhjeve të mundshme për sanimin e dëmeve të shkaktuar nga deponia;
- U mbajt punëtorja e defenimit të pakos së politikave dhe instrumenteve për zhvillimin e projektve të qëndrueshme investuese në të ardhmen, për menaxhimin e sektorit të nevojshme për harmonizimin e direktivave të BE-së;
- Pjesëmarrje e ministrit Duraku në takimin e punës me Odën Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) me kryetarin e Qeverisë Zoran Zaev dhe përfaqësuesit e resorëve ekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe afaristëve në të cilat diskutohet për politikat ekonomike reformuese, për masat e parapara ekonomike, si dhe për problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti i biznesit në këtë rajon; dhe
- Pjesëmarrje e zëvendësministrit të mjedisit jetësor Jani Makraduli në takimin joformal të ministrave të mjedisit jetësor në kryesimin e Estonisë në Talin, Estoni.

Takime me:

- Ambasadorin e Republikës së Francës, Kristian Timonie;
- Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Fatos Reka;
- Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Maqedoni, Samuel Zhbogar;
- Ambasadoren e Zvicrës në Maqedoni, Sibil Suter, Tejada;
- Ambasadoren e Austrisë në Republikën në Republikën e Maqedonisë, E.T. Renate Kobler;
- Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë në Republikën e Maqedonisë Millan Jazbec;
- Ambasadorin e Republikës së Finlandës në Republikën e Maqedonisë, E.T. Perti Ikonen;
- Përfaqësuesen e përhershme të UNDP-së në Maqedoni, Luiza Vinton;
- Përfaqësuesen e Bankës Evropiane për Zhvillim të Maqedonisë (EBOR), Anka Joana Jonesku; dhe
- Drejtorin e delegacionit të Odës Gjermane në Maqedoi me qëllim të shqyrtimit drejtimet e mundshme në fushën për menaxhimin me mbeturina



Marrëveshje të lidhura

- Memorandumin për implementimin e Marrëveshjes Kornizë mes Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Komuniteteve evropiane për procedurat për implementimin e ndihmës financiare nga Unioni;
- U lidhën më shumë se 14 marrëveshje me komunat në Republikën e Maqedonisë për shpërndarjen e financave dhe realizimin e programeve dhe projekteve nga fusha e mjedisit jetësor.
- U lidh Marrëveshja për mbylljen e deponive të egra jostandarde në Rajonin Malor Lindor dhe Verilindor dhe furnizim me pajisje për grumbullim dhe transportim të mbeturinave të komunës, nëpërmjet Programit IPA; dhe
- Furnizim i stacionit mobil monituorues, tip i ndryshëm i analizatorëve dhe automjeteve për mirëmbajtjen e sistemit, si dhe ndryshimin e pajisjes të vjetruar për monitorim të cilësisë së ajrit në Tetovë, Kumanovë dhe Manastir.

MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR KOMUNIKIM, LLOGARIDHËNIE DHE TRANSPARENÇË

- Robert Popovski

Ministri pa resor i angazhuar për Komunikim, Llogaridhënie dhe Transparencë Robert Popovski mori pjesë në formimin e sektorit profesional për komunikime, me qëllim të mundësohet transparencë dhe hapje më e madhe e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Gjithashtu Sektori i Komunikimeve përgatit, harton, ndjek dhe informon për aktivitetet publike të kryeministrit Zaev. U miratua vendimi për ndërprerjen e reklamave qeveritare dhe filloi me publikimin agjendave dhe procesverbaleve nga seancat qeveritare, si dhe mbajtjen e takimeve për informim (brifing) me gazetarët dhe redaktorët.

Reforma

- U formua Sektori profesional për komunikime dhe për transparencë dhe hapje më të madhe të Qeverisë;
- **Publikimi i rregullt i agjendave ditore të seancave qeveritare në ueb-faqen e Qeverisë (3-6-9); dhe**
- **Vendim për ndërprerjen e reklamave qeveritare të radiodifuzerëve komercial dhe mediave të shtypura, afisheve, internet portalet (me përjashtim të mediave sociale dhe transmetimin e komunikimit me qytetarët nëpërmjet servisit publik radiodifuziv (3-6-9));**

Evenimente

- Pjesëmarrje e ministrit Popovski në debatin publik për Reformat në hapësirën mediatike bashkërisht me ministrin Mançevski;
- Organizimi i nënshkrimit celebrues të Marrëveshjes për bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë, duke përfshirë nderimet më të larta shtetërore dhe ushtarake;
- Pjesëmarrje në organizimin e celebrimeve me rastin e “Ditës së Republikës”, më 2 gusht, kremtimin e përbashkët për Ilindenin, të kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev dhe kryetarit të Republikës së Bullgarisë, Bojko Borisov, manifestimin qendror për “Ditën e Pavarësisë”, më 8 shtator;
- **Takime (brifing) të rregullta javore me gazetarët dhe redaktorët (3-6-9); dhe**
- Përgatitjen e rregullt, përcjelljen dhe informimin e aktiviteteve publike të kryeministrit Zoran Zaev, siç është vizita e kryeministrit në Bruksel, Samiti i shefave të shteteve në Trieste, takimi në Kartën e Adriatikut në Podgoricë, vizita në fabrikën e tekstit në Shtip, takimi joformal me kryeministrat nga rajoni në Shqipëri, nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale në Bosnje dhe Hercegovinë, kremtimin e festës së Kurban Bajramit në Haraçinë, bisedimet ekonomike me dyqanxhinjtë dhe të rinjtë nga Velezi dhe takimi ekonomik në Izrael.



Mbi tetë takime me:

- Përfaqësuesit e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë dhe Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Mediave, së bashku me kryeministrin Zoran me qëllim të theksimit të përcaktimit të Qeverisë ndaj reformave mediatike, si hap i rëndësishëm i euro -integritimeve;
- Ambasadorin e Bashkimit Evropian, Samuel Zhbogar ku u diskutua për reformat e domosdoshme të medimeve;
- Ekspertin e lartë të Bashkimit Evropian, Rajnhard Pribe, me temën : “Angazhimet e Qeverisë për krijimin e ambientit demokratik për punën e pavarur dhe demokratike të gazetarëve dhe medimeve;
- Ambasadorin e Hollandës, Vauter Plomp;
- Ambasadorin e ShBA-së, Xhes Bejli; dhe
- Zëvendës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Maqedoni, Pol Edvards.

MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR DIASPORËN

- Edmond Ademi

Me qëllim të afrimit të Diasporës me Republikën e Maqedonisë dhe zhvillimin e bashkëpunimit në politikë, ekonomi, kulturë, në arsim dhe shkencë. Ministri pa resor i angazhuar për Diasporën Edmond Ademi prezantoi Informacionin për hartimin e Strategjisë kombëtare për bashkëpunim me Diasporën që nga pavarësia e Maqedonisë, e cila u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dhe realizoi mbi 15 takime me ministra relevantë, ambasadorë, institucionet dhe organizatat.

Reformat

- U miratua Informacioni për hartimin e Strategjisë kombëtare për bashkëpunim me Diasporën që nga pavarësia e Maqedonisë e cila u miratua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Dy evenimente

- Pjesëmarrje në publikimin „From Diaspora to Diversities“ me ftesë të ministrit të kulturës Robert Allagjazovski; dhe
- Pjesëmarrje në Forumin tematik “Sfidat, perspektivat dhe potencialet e migracioneve”, organizuar nga CIVICA Mobilitas.

Mbi 15 takime me:

- Drejtorin e përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (International Organization for Migration) Vilijam Lejsi Sving, ku në takim u shqyrtua mundësia që Republika e Maqedonisë në vitin 2018 të jetë nikoqire e Samitit të Ministrave për Diasporën;
- Ministren e punëve të jashtme të Australisë Xhuli Bishop, së bashku me kryeministrin Zoran Zaev dhe ministrin e punëve të jashtme;
- Ministren për Drejtat e Njeriut dhe Refugjatët Samiha Borovac, si pjesë e delegacionit i kryesuar nga kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev, i shoqëruar nga Oliver Spasovski, ministër i punëve të brendshme, Lupço Nikollovskim, ministër i bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave, Kreshnik Bektashi, ministër i ekonomisë, Robert Allagjazovski, ministër i kulturës në takimin e parë zyrtarë në Bosnje dhe Hercegovinë;
- Kryetarin e Odës Ekonomike Veriperëndimore të Maqedonisë, Nebi Hoxha dhe me anëtarin e Odës Amerikano- Izraelite, Mamut Skenderi;
- Kryetaren e Asociacionit të Maqedonasve në Britaninë e Madhe, Bona Petrovska;
- Shefen e zyrës së Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM), Sonja Bozhinovska- Petrushevska;
- Përfaqësueset e Forumit për Maqedoni Demokratike, Emilija Todorova dhe Maja Panova;
- Përfaqësues të Shoqatës për Fëmijët Refugjatë nga Pjesa e Egjeut të Maqedonisë;
- Përfaqësues të Lidhjes së Diasporës Shqiptare për Maqedoninë;
- Delegacion e Diasporës së Bashkuar Maqedonase- DBM. të kryesuar nga kryetari Meto Kolovski;
- Ambasadorin e Polonisë në Republikën e Maqedonisë, Jacek Multanovski;
- Ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Maqedonisë, Fatos Reka;
- Ambasadorin e Republikës së Sllovenisë, Millan Jazbec dhe ambasadorin e Republikës së Kroacisë, Danijela Barishiq;
- Zëvendës ambasadorin e Britanisë së Madhe në Republikën e Maqedonisë, Pol Edvards;
- Ambasadorin e Republikës së Greqisë, Dimitrios Janakakis; dhe
- Ambasadorin e ShBA- së Xhes Bejli.



MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR INVESTIME TË HUAJA

- Adnan Qahil

Ministri pa resor i angazhuar për Investime të Huaja realizoi më shumë se 56 takime me investitorë të huaj potencial të interesuar për klimën investuese në Republikën e Maqedonisë, investitorët aktual për mundësinë për rritjen potenciale të investimeve ekzistuese dhe përfaqësuesit e kompanive ekzistuese, të cilat janë në proces me investimet. Gjithashtu, ministri realizoi edhe 11 takime me ambasadorët relevantë, ministrat dhe institucionet relevante.

Dy evenimente

- Prezantimin e gjendjes së investitorëve të huaj në Odën Ekonomike të Maqedonisë- Turqisë; dhe
- Pjesëmarrje të ministrit Qahil në panel diskutimin me temë “Mundësitë e investimit në Ballkan”, organizuar nga Asociacioni i Pavarur i Industrialëve dhe Biznesmenëve – MUSIAD.

Mbi 11 takime me :

- Sh.S. Tulin Erkal Kara, ambasadorin e Republikës së Turqisë në Republikën e Maqedonisë;
- Sh.T. Predrag Mitroviq, ambasadorin e Republikës së Malit të Zi;
- Mevlud Çavushoglu, ministrin e punëve të jashtme të Republikës së Turqisë;
- Lupço Nikollovskin, ministrin e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave në Republikën e Maqedonisë;
- Bunjamin Kutlu, përgjegjës në selinë tregtarë të Republikës së Turqisë;
- Sh. T. Hoseim Karimi, ambasadorin e Republikës Islame Iran;
- Rexhep Taip Erdogan, presidentin e Republikës së Turqisë; dhe
- Përfaqësuesit e Agjencisë së Kadastrës për Patundshmëri, Agjencisë për Investime të Huaja, Drejtorinë për zhvillim zonave teknologjike- industriale dhe Biron për Metrologji.

MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR AVANCIMIN E KLIMËS INVESTUESE PËR NDËRMARRJET E VENDIT

- Zoran Shapuriq

Ministri pa resor i angazhuar për avancimin e klimës investuese për ndërmarrjet e vendit- Zoran Shapuriq ndërmori masa dhe aktivitete në drejtim të zvogëlimit të emetimit të gazrave serrë dhe sigurimin e uljes sa më të madhe të rritjes së dioksid karbonit, menaxhimin me mbeturina, si dhe ndarjen e tokës ndërtimore në Strumicë për ndërtimin e reparteve industriale. Dorëzoi dhe Propozim- ndryshim për Ligjin për mbrojtje të konsumatorëve dhe Ligjit për minerale të lëndës së parë që u aprovua nga Qeveria. Gjithashtu në Qeveri dorëzoi Propozim- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për taksë komunale. Realizoi më shumë takime me përfaqësuesit e odave, menaxhmenteve të kompanive dhe ambasadorëve, dhe realizoi më shumë vizita në deponinë e Strugës dhe TIRZ.

Ligjet

- Propozim- ndryshim për Ligjin për mbrojtje të konsumatorëve që u aprovua nga Qeveria;
- Propozim- ndryshim të Ligjit për minerale të lëndës së parë që u aprovua nga Qeveria;
- Propozim- ndryshim dhe plotësim të Ligjit për taksë komunale dorëzoi në Qeveri..

Reforma

- Së bashku me ministrin Sadulla Duraku u morën masa dhe aktivitete për zgjidhje afatshkurtër në drejtim të zvogëlimit të emetimit të gazrave serrë dhe sigurimin e uljes sa më të madhe të rritjes së dioksid karbonit, kurse në plan afatgjatë- ndryshim të rregullore për menaxhimin me mbeturina, sidomos me deponitë, dhe plan afatgjatë- qasje rajonale të menaxhimit me mbeturinat;
- Së bashku me ministrin Sadulla Duraku pjesëmarrje aktive në ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike, informimin e opinionit të gjerë për rendësin e kësaj marrëveshjeje, i cili është obligim në përputhje me obligimet e ndërmarra të BE-së; dhe
- Filluan bisedimet e u.d. kryetarit e Strumicës për ndërtimin e stacionit të pastrimit në harmonizim me rregulloren dhe standardet e BE-së, si dhe për nevojën e ndarjes së tokës punues të komunës 20.000m² në zonën industriale Veri, ku do të ndërtohen reparte industriale, që do të avancojnë ekonominë e komunës dhe rajonit më gjerë.

Mbi 27 takime :

- Odën e Arkitektëve dhe Inxhinierëve të Autorizuar, në të cilën u diskutua për problemet e tyre lidhur me të gjithë procesin të ndërtimit, për ndërtimtari si pjesë e rëndësishme e ekonomisë së vendit dhe për rregulloren e këtij vendi, sidomos për pasigurinë si pasojë e ndryshimit të shpeshtë të ligjeve dhe nevojës për saktësim të mëtutjeshëm të rregullores për euro-kodet dhe standardizimin në harmonizim me rregulloren e BE-së dhe u informuam për zgjatjen tarifës së lirë të energjisë elektrike në përputhje me programin qeveritar;
- Lidhjen e Odave Ekonomike dhe Odës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë me qëllim të avancimit të biznes klimës në RM, në harmonizim me programin qeveritar;
- Menaxhmentet e 25 kompanive me qëllim të njohjes së problemeve me të cilat ballafaqohen gjatë punës së promovimit të masave dhe aktiviteteve të Qeverisë me qëllim të përmirësimit të klimës së biznesit; dhe



- Disa takime me qëllim të përsheptimit të proceseve për anëtarësimin e plotë të RM-së në BE dhe NATO, dhe atë me eurombasadorin Samuel Zhbogar, deputetin evropian Hans van Belen, ambasadorin e Mbretërisë së Hollandës Vauter Plomp dhe ambasadorin e Malit të Zi Predrag Mitroviq.

Tre evenimente

- Më shumë vizita në deponinë e Strugës, bashkërisht me ministrin Sadulla Duraku dhe ministrin Ramiz Merko;
- Vizitë në TIRZ bashkë me ministren Zorica Apostolloska, ministrin Ramiz Merko dhe me investitorët e tjerë aktual të huaj, me qëllim të shpjegimit të përcaktimit të Qeverisë për respektimin e obligimeve të ndërmarra tashmë nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet tyre dhe shtetit, në përputhje me rregulloret e së drejtës ndërkombëtare komerciale; dhe
- Pjesëmarrje në Thirrjen e tretë për projektin “Ekspertët e huaj për kompanitë e vendit” me qëllim të përmirësimit të kushteve për punën e kompanive vendase dhe klimën e biznesit në shtet, si dhe animimin e kompanive të vendit për pjesëmarrje në thirrjen konkrete.

MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR STRATEGJINË E AVANCIMIT TË GJENDJES SË ROMËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

- Samka Ibrahimovski

Ministri pa resor i angazhuar për implementimin e Strategjisë për avancimin e gjendjes së romëve në Republikën e Maqedonisë Samka Ibrahimovski me sukses ka realizuar aktivitete me të cilat u zgjidh problemi i gjinekologut në Komunën e Shuto Orizares. U realizuan më shumë se dhjetë takime me përfaqësuesit nga ministrinë përkatëse të angazhuara për implementimin e Strategjisë së romëve, Delegacionin e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, si dhe me qytetarët të Koçanit, Shtipit dhe Gostivarit ku u diskutua për problemet me të cilat ballafaqohen në përditshmëri në nivel lokal. U lidh edhe Marrëveshja për bashkëpunim me Universitetin MIT- Shkup, si dhe u organizuan katër evenimente publike.

Reformat

- Zgjidhja e problemit me gjinekologun në Komunën e Shuto Orizares.

Katër evenimente

- Shënimi i "Ditës së gjenocidit ndaj romëve nga Lufta e Dytë Botërore" në Qendrën e Memorialit të Holokaustit të Hebrenjve në Maqedoni;
- Aktivitete përgatitëse për shënimin e "Ditës së Alfabetit Rom" në nëntor;
- Pastrimin e deponisë në rrugën rajonale Manastir- Resnje; dhe
- Debat i hapur me temë "Inkluziv shoqëror për kategoritë e rrezikuara të qytetarëve nëpërmjet arsimimit" me organizim të ministrit Ibrahimovski dhe Universitetit MIT- Shkup.

Mbi dhjetë takime me :

- Përfaqësuesit e ministrive përkatëse të angazhuara për implementimin e Strategjisë për romët;
- Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për zgjidhjen e problemit me gjinekologun në Shuto Orizare;
- Ministrin e kulturës, Robert Alagjovovski, për inicimin e procesit për hapjen e Qendrës Kulturore Rome në Shkup;
- Ministren e arsimit, Renata Deskosk dhe Latif Demir, themelues i Katedrës dhe profesor i Romistikës në Fakultetin Filozofik në Zagreb, me qëllim të shqyrtimit të propozimit për hapjen e Katedrës Rome në Fakultetin Pedagogjik në Shkup.
- Kryetarin e Bordit drejtues të EVN-së, Stefan Petar, ku u diskutua për mundësinë e lidhjes së energjisë elektrike në lagjet me popullatë romë;
- Përfaqësuesit e Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë, ku u iniciua Evalvimi implementimit të deritanishëm të Dekadës së Romëve 2005-2015, si dhe Strategjisë së Romëve; dhe
- Qytetarët nga Koçani, Gostivari dhe Shtipi ku në fokus ishte implementimi i Strategjisë për romët në nivel lokal.

Marrëveshje të lidhura

- Marrëveshje me Universitetin MIT në Shkup për ndarjen e 10 bursave për studime deri diplomike falas.



MINISTRJA PA RESOR E ANGAZHUAR PËR INVESTIME TË HUAJA

-Zorica Apostoloska

Ministrja pa resor e angazhuar për investime të huaja, Zorica Apostolska mori pjesë në më shumë se tetë ngjarje dhe realizoi mbi 14 takime me përfaqësuesit e investitorëve aktual dhe atyre potencial nga fusha e sektorit të energjetikës, industrisë automobilistike, arsimit, dhe zhvillimit teknologjik industrial.

Mbi tetë takime

- Takim me investitorët aktual në RM, me organizim të zëvendëskryetarit e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë d-r Koço Angjushev;
- Mëngjes pune me Lidhjen e Odave Ekonomike;
- Eveniment promovues për projektin “Ekspertët e huaj për kompanitë e vendit”;
- Vizita në Zonë zhvillimore teknologjike- industriale Bunarxhik;
- Vizitë në Drejtorinë për zonat zhvillimore teknologjike; dhe
- Tre takime me Këshillin për ndjekjen e gjendjes së sistemit pensional.

Mbi 14 takime me :

- Përfaqësuesit e 9 kompanive të huaja- investitorë potencial (Greqi, Itali, ShBA, Kinë, Indi, Romani, Turqi etj.) në sektorin energjetik, industrinë automobilistike, arsimit, sektorin financiar si dhe sektorë të tjerë;
- Përfaqësuesit e tre kompanive të huaja, të cilët janë në fazë të realizimit të “grinfeld” investimeve të paralajmëruara, me qëllim të tejkalimit të problemeve me të cilat ballafaqohen dhe vazhdon aktiviteti i tyre deri në realizimin e plotë investimit;
- Kompania gjermane VIK Grup, për realizimin e projektit investues në TIRZ potenciale në vendin tonë para biznesit italian në rajon Pula, Itali;
- Delegacionin e Ekonomisë gjermane në Maqedoni për nxitjen e bashkëpunimit bilateral dhe investimeve, lobimit dhe prezantimit të potencialeve të Republikës së Maqedonisë para rajoneve gjermane/kompanive përfshirë dhe prezantimin e pilot projektit për aprovimin e arsimit të mesëm dual në Republikën e Maqedonisë në funksion të krijimit të kapacitetit të duhur të stafit profesional për nevojat e kompanive/investitorëve; dhe
- Përfaqësuesit e Odës Ekonomike Italiane - Maqedonase për përkrahje dhe prezantim të potencialeve për investim në Maqedoni para komunitetit të biznesit të Italisë..

MINISTRI PA RESOR I ANGAZHUAR PËR INVESTIME TË HUAJA

- Ramiz Merko

Ministri pa resor e angazhuar për investime të huaja, Ramiz Merko, realizoi 10 takime me investitorët aktual dhe atyre potencial, si dhe me përfaqësuesit e odave ekonomike dhe industrisë, por edhe me institucionet relevante nga fusha e turizmit dhe zhvillimit industrial teknologjik. Ministri Merko mori pjesë në promovimin në thirrjen publike “Ekspertët e huaj për kompanitë vendase” dhe në mëngjesin zyrtar të organizuar nga Lidhja e Odave Ekonomike.

Dy evenimente

- Promovimin e thirrjes së tretë publike për projektin “Ekspertët të huaj për kompanitë vendase”; dhe
- Pjesëmarrje në mëngjesin zyrtar të organizuar me Lidhjen e Odave Ekonomike të Republikës së Maqedonisë.

Mbi dhjetë takime me:

- Presidentin e Shqipërisë Ilir Meta, kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj dhe përfaqësuesit e odave ekonomike dhe industrive, si dhe me afaristët shqiptarë;
- Udhëheqësin e sektorit të Agjencisë për Promovim dhe Përkrahje të Turizmit në Republikën e Maqedonisë, Zoran Nikolovski;
- Përfaqësuesin nga Drejtoria për zhvillim teknologjik dhe industrial;
- Përfaqësuesin e Agjencisë për Investime të Huaja;
- Kompaninë Nordic Invest për investime për prodhim të energjisë foto valtike;
- Kompaninë Schnell për investime në sektorin e turizmit; dhe
- Kompaninë Elkos Group për marrjen me koncesion të fabrikës TIPOS në Butel/ Shkup me qëllim të ridestinimit dhe qendrës tregtare shumë-funksionale.

FJALA
FJALË!
100
DITË
QEVERI PËR QYTETARËT ●



QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË